




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Ministria e Zhvillimit Ekonomik  
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development*



# STRATEGJIA MINERARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 2012 – 2025



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK**  
**MINISTARSTVO EKONOMSKOG RAZVOJA**  
**MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT**

# STRATEGJIA MINERARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 2012 – 2025

Prishtinë, 2012



## SHKURTESAT

Ag	Argjendi
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
Bi	Bismuthi
ÇB	Çuka e Batllavës
Cd	Kadmiumi
Co	Kobalti
Cr	Kromi
Cu	Bakri
ESTAP III	Projekti i Asistencës Teknike për Sektorin e Energjisë III
ETR	Elementet e Tokave të Rralla
Fe	Hekuri
GDK	Gjeodatabaza e Kosovës
INKOS	Instituti “Inkos” sh.a.
JORC	(Joint Ore Reserves Committee) Komiteti i Përbashkët i Rezervave dhe Xehëve
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
MD	Masivi Dardan
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MGP	Metalet e Grupit të Platinës
Mn	Mangani
Mt	Milion ton
Ni	Nikeli
NSH	Ndërmarrje Shoqerore
OJQ	Organizat Joqeveritare
OMAC	Laborator - Irlandë
Pb	Plumbi
PERC	(Pan-European Reserves & Resources reporting Committee) Kodi i Komitetit Pan-Evropian
PGK	Plani i Guroreve të Kosovës
PMRM	Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerare
RWE	Rheinisch-Westfälisches Elektrizitätswerk
SWOT	Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet
TC	Termocentrali
t/v	ton/vit
t	ton
UNFC	Korniza e Klasifikimit të Kombeve të Bashkuara
Zn	Zinku

# PËRMBAJTJA

SHKURTESAT.....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
1. HYRJJE .....	7
2. VIZIONI DHE MISIONI PËR SEKTORIN MINERAR.....	8
2.1 VIZIONI DHE MISIONI .....	8
3. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE LIGJORE.....	9
3.1. INSTITUCIONET DHE NDERMARRJET E SEKTORIT MINERAR.....	9
3.1.1 Institucionet .....	9
3.1.2 Ndermarrjet e sektorit .....	9
3.2. KORNIZA LIGJORE .....	11
4. GJENDJA DHE POTENCIALI I SEKTORIT MINERAR .....	13
4.1. RESURSET MINERARE.....	13
4.1.1 <i>Mineralet Energjitike</i> .....	13
4.1.1.1 Qymyri .....	13
4.1.1.2 Urani.....	20
4.1.1.3 Resurset tjera (Nafta dhe Gazi).....	21
4.1.2 <i>Mineralet metalore</i> .....	21
4.1.2.1 Plumbi (Pb), Zinku (Zn) dhe Argjendi (Ag).....	21
4.1.2.2 Nikeli (Ni) dhe Kobalti (Co) .....	24
4.1.2.3 Boksitet.....	25
4.1.2.4 Hekur-nikeli, kromi, mangani dhe bakri.....	25
4.1.2.5 Metalet e rralla dhe Elementet e tokave të rralla .....	26
4.1.2.6 Metalet e grupit të arit dhe platinit.....	27
4.1.3. <i>Mineralet jo-metalore</i> .....	27
4.1.3.1 <i>Mineralet industriale</i> .....	27
4.1.3.2 <i>Mineralet teknike</i> .....	
4.1.4 <i>Materialet ndërtimore</i> .....	29
5. ANALIZA E AFTËSISË KONKURRUSE - SWOT .....	32
6. SFIDAT PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT MINERAR .....	34
7. OBJEKTIVAT, POLITIKAT DHE MASAT PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT MINERAR.....	35
SHTYLLA I. Krijimi i kushteve të favorshme për shfrytëzim dhe valorizim ekonomik të resurseve minerare dhe tërheqje të investimeve.....	35
Objektiva I.1. <i>Plotësimi i Infrastrukturës ligjore dhe rregullatore</i> .....	35
Objektiva I.2. <i>Hartimi i politikave zhvillimore për sektorin minerar</i> .....	36
Objektiva I.3. <i>Zhvillimi i politikave fiskale</i> .....	37
Objektiva I.4. <i>Realizimi i rivlerësimit ekonomik të potencialit minerar</i> .....	39
SHTYLLA II. Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në fushën e sektorit minerar .....	39
Objektiva II.1. <i>Zhvillimi institucional dhe i kapaciteteve njerëzore</i> .....	39
Objektiva II.2. <i>Hulumtimi i resurseve minerare dhe raportimi i tyre</i> .....	40
SHTYLLA III. Çështjet sociale dhe përfitimet e komunitetit .....	41
Objektiva III.1. <i>Trajtimi i çështjeve sociale dhe siguria në punë</i> .....	41
Objektiva III.2. <i>Pjesëmarrja dhe përfitimi i komunitetit</i> .....	42
SHTYLLA IV. Përkujdesja për mjedisin .....	42
Objektiva IV.1. <i>Zgjidhja e problemeve mjedisore historike</i> .....	42
Objektiva IV.2. <i>Mbrojtja e mjedisit nga aktiviteti minerar</i> .....	43
8. PROCESI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË MINERARE 2012 - 2025 .....	44
8.1. PROGRAMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË MINERARE .....	44
8.2. Metodologjia për përgatitjen dhe monitorimi i programit.....	44

---

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe social i Kosovës dhe mirëqenia e qytetarëve është prioritet kryesor i institucioneve shtetërore të Kosovës.

Realizimi i këtij prioriteti varet nga planifikimi dhe zbatimi i reformave strukturore ekonomike, të cilat mundësojnë shfrytëzimin optimal të resurseve natyrore dhe njerëzore të Kosovës dhe hapjen e rrugës zhvillimore për sektorin privat, ku parimi i krijimit të ambientit të mirë për biznes dhe hapja e vendeve të qëndrueshme të punës do të jenë bazë për zhvillim afatgjatë të vendit.

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës është një dokument i Qeverisë së Kosovës që krijon mundësi reale për shfrytëzimin sa më racional dhe zhvillimin e qëndrueshëm të resurseve minerare. Ky dokument synon të jetë udhërrëfyes për institucionet relevante për menaxhim të përgjegjshëm të pasurive minerale me qëllim të valorizimit të resurseve minerare ekzistuese dhe identifikimin e resurseve të reja minerale.

Qëllimi primar i kësaj strategjie është të krijojë kushtet për zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm të sektorit mineral, i cili kontribuon në mirëqenien e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës është hartuar në bazë të vizionit ekonomik të Qeverisë së Kosovës, ku zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, forcimi i sektorit mineral, miratimi i legjislacionit adekuat, reforma strukturore ekonomike dhe edukimi i gjeneratave të reja janë parimet bazë për të ardhmen ekonomike të Kosovës. Kjo strategji bazohet në katër shtylla themelore. Këto shtylla paraqesin kornizën për krijim të politikave dhe planeve të veprimit, të cilat definojnë se si institucionet dhe sektori mineral do të angazhohen për hulumtimin dhe zhvillimin e resurseve minerare si dhe zhvillimin e sektorit mineral në tersi.

### **Shtylla e parë: Krijimi i kushteve të favorshme për shfrytëzim dhe valorizim ekonomik të resurseve minerare dhe tërheqje të investimeve.**

Institucionet e Kosovës do të vendosin një bazë të qartë legjislative dhe politika sektoriale me qëllim përkrahjen dhe zhvillimin e sektorit mineral. Kjo bazë ligjore do të mundësojë vazhdimin e ristrukturimit të sektorit ekzistues mineral, avancimin e aftësive konkurruese të tyre në tregun vendor dhe ndërkombëtar si dhe do të mundësojë krijimin e perspektivave të reja për shfrytëzimin dhe përpunimin e resurseve minerale. Valorizimi i resurseve/rezervave minerale nënkupton vendosjen e resurseve minerale të Kosovës, posaçërisht ato të linjtitit dhe të xeheve Pb-Zn, në funksion të zhvillimit të mirëfilltë ekonomik të vendit. Gjithashtu, synohet realizimi i programit për gjenerimin e energjisë elektrike nga qymyret si dhe prodhimi i metaleve bazike me synim eksportin, çka do të ndikojë pozitivisht në bilancin tregtar me jashtë. Për më tepër, nëpërmjet këtyre politikave, Qeveria synon të krijojë një gjenerator të fuqishëm edhe për zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, të bazuar në shfrytëzimin e resurseve minerale vendore, për arritjen e objektivave të vizionit ekonomik të Qeverisë së Kosovës.

### **Shtylla e dytë: Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe Institucionale në sektorin mineral**

Rritja e kapaciteteve të institucioneve relevante shkencore dhe edukativo-arsimore do të mundësojë zhvillimin e industrisë minerare sipas kërkesave të tregut dhe standardeve ndërkombëtare. Kosova ka bartur një kapital njerëzor me ekspertizë të vlefshme profesionale në këtë fushë, por aktualisht shihet si imediate nevoja e ripërtëritjes dhe zhvillimit të mëtytjeshëm të këtij kapitali, për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të institucioneve, si dhe sektorit në përgjithësi.

---

### **Shtylla e tretë: Çështjet sociale dhe përfitimet e komunitetit**

Kjo strategji, gjithashtu definon veprimet dhe nismat për trajtim të sektorit minerar bazuar në përparësitë e vendit, për të mundësuar që zhvillimi i sektorit minerar të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve, si pronarë natyralë të këtyre resurseve. Pjesëmarrja e komuniteteve dhe përfitimet përmes punësimeve të banorëve dhe zhvillimit të infrastrukturës lokale do të kenë një ndikim të rëndësishëm social dhe do të mund të nxisin zhvillimin rajonal në Kosovë.

### **Shtylla e Katërt: Përkujdesja për mjedisin**

Mjedisi miqësor dhe i shëndetshëm ka rëndësi primare për qytetarët e Kosovës. Rrjedhimisht, kjo strategji e konsideron si shumë të rëndësishme mbrojtjen e mjedisit dhe garanton marrjen e masave të nevojshme për minimizimin e ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga aktiviteti minerar.

Shtyllat e lartpërmendura në vetvete përmbajnë objektiva, politika zhvillimore dhe veprime. Objektivat janë shkoqitur dhe detajuar në kuadër të kësaj strategjie, ndërsa politikat zhvillimore do krijojnë kornizë të qartë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe trajtim miqësor për mjedisin, duke përkrahur hulumtimin, nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve si dhe zhvillimin e tërësishëm të sektorit minerar në Kosovë. Veprimet/Masat do të jenë mbështetje për institucionet relevante, do të sigurojnë që sektori minerar të ofrojë përfitime substanciale dhe të qëndrueshme për ekonominë e vendit, si dhe do të minimizojnë ndikimet negative.



## 1. HYRJE

Strategjia Minerare është një vlerësim i gjendjes aktuale dhe perspektivës së këtij sektori thelbësor për ekonominë e vendit, me potencialet minerale, sfidat që duhet të përballojnë institucionet administrative e teknike të saj dhe masat e programuara për zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë.

Eksperienca e deritanishme e vendeve të pasura me resurse minerare dëshmon se ato kanë pasur përgjithësisht mundësinë të zhvillohen me hapa më të shpejtë atëherë kur kanë zbatuar politikat më të përshtatshme në sektorin e shfrytëzimit të mineraleve.

Republika e Kosovës është e pasur me resurse minerare, ku resurset energjetike dhe ato të metaleve me ngjyrë, paraqesin potencial të rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm. Mund të veçohen linjiti, mineralet e plumbit, zinkut, argjendit dhe arit, mineralet silikate të nikelit dhe kobaltit, të hekur - nikelit, boksitit, manganit, magnezitit dhe një numër i konsiderueshëm i mineraleve jo-metalore, industriale dhe materialeve gjeologjike ndërtimore. Shfrytëzimi racional dhe i menaxhuar mirë i këtyre resurseve mund të sigurojë mbështetje për zhvillimin e shpejtë e të qëndrueshëm ekonomik e social.

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe social është prioritet kryesor i Qeverisë së Kosovës. Realizimi i këtij prioriteti varet nga planifikimi dhe zbatimi i reformave strukturale ekonomike, të cilat mundësojnë shfrytëzimin optimal të resurseve minerare dhe njerëzore të Kosovës dhe hapjen e vendeve të qëndrueshme të punës për zhvillim afatgjatë të vendit. Strategjia Minerare është një dokument i Qeverisë së Republikës së Kosovës që krijon mundësi reale për shfrytëzim racional dhe të qëndrueshëm të resurseve minerale. Ky dokument synon të jetë udhërrëfyes për institucionet relevante për menaxhim të përgjegjshëm të pasurive minerale me qëllim të valorizimit të resurseve ekzistuese dhe hulumtimin e resurseve të reja minerale. Kjo do të krijojë kushtet për zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm të sektorit minerar i cili kontribuon në mirëqenien e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Strategjia Minerare përfshin periudhën kohore 2012-2025. Ajo do të zbatohet nga aktorët relevant të sektorit minerar. Përgjegjëse për koordinimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës është Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

### Parimet udhëheqëse për zbatimin e Strategjisë Minerare

Shfrytëzimi i resurseve minerare është një ndër shtyllat më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe për krijimin e vendeve të punës në Kosovë. Kjo Strategji bazohet në punën e profesionistëve të fushës, në inputet e autoriteteve lokale, në planet zhvillimore të ndërmarrjeve ekzistuese minerare, në planet e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale si dhe është në harmoni të plotë me Vizionin Ekonomik dhe Planin e Veprimtimit për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik të Qeverisë së Kosovës. Partneriteti me shoqërinë civile dhe komunikimi i rregullt me qytetarë do mundësojë që kjo Strategji të sjellë përfitime për të gjitha shtresat e shoqërisë kosovare.

Zhvillimi i industrisë minerare, do mundësojë funksionalizimin e minierave ekzistuese dhe hapjen e minierave të reja duke krijuar vende të reja pune dhe mundësi biznesi, jo vetëm për sektorin minerar, por edhe për industrinë dhe shërbimet përcjellëse. Kjo kërkon nivel të lartë të aktiviteteve hulumtuese për identifikimin e resurseve të reja minerale, zhvillimin e minierave të reja dhe industrisë përpunuese minerare. Karakteristikat kyçe të vizionit ekonomik dhe të kësaj strategjie janë:

- Të ofrojë përfitime afatgjata ekonomiko-sociale për Kosovën;
- Kontribuojë në arritjen e objektivave zhvillimore ekonomike;
- Të punojë për mbrojtjen e mjedisit dhe të minimizojë efektet negative;
- Të mundësojë tërheqjen e investimeve të reja në sektor.



---

## 2. VIZIONI DHE MISIONI PËR SEKTORIN MINERAR

### 2.1 Vizioni dhe Misioni

#### VIZIONI

Zhvillimi i resurseve minerare dhe zgjerimi e modernizimi i industrisë së përpunimit mineral për të garantuar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e mirëqënies për qytetarët e Republikës së Kosovës.

#### MISIONI

Krijimi i të gjitha kushteve ligjore dhe institucionale për rritjen e shpejte të investimeve në sektorin mineral, forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e interesit të komunitetit dhe garantimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

---

## 3. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE LIGJORE

### 3.1. Institucionet dhe ndërmarrjet e sektorit mineral

#### 3.1.1 Institucionet

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik** është themeluar me Vendim të Kuvendit Nr. 218 të datës 24.02.2011, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive.

MZHE është përgjegjës për hartimin e politikave dhe strategjisë për zhvillimin ekonomik, monitorimin e ndërmarrjeve publike, përgatit dhe zbaton politikat, dokumentet e strategjive për sektorin e energjisë, minierave, sektorin postar, sektorin e telekomunikacionit dhe sektorin e teknologjisë informative, dokumentet e balanceve të energjisë, Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë sipas legjislacionit në fuqi. Bashkëpunon në përgatitjen dhe implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në sektorin e energjisë, minierave, sektorin postar, sektorin e telekomunikacionit dhe sektorin e teknologjisë informative. Bashkëpunon me komunitetin e biznesit dhe asociacionet e biznesit më qëllim krijimin e një mjedisi të përshtatshëm biznesor.

MZHE ka të gjitha përgjegjësitë e tjera që ka pasur Ministria e Energjisë dhe Minierave në sektorin e Energjisë dhe Minierave.

**Komisioni i Pavarur për Minierat dhe Mineralet** fillimisht i themeluar me rregulloren Nr. 2005/2 të 21 Janarit 2005 (të ndryshuar me rregulloren nr. 2005/38 të 29 Korrikut 2005 dhe Ligjin nr. 03/L-81 të datës 13 Qershor 2008), përcaktohet si agjenci e pavarur në përputhje me nenin 119 paragrafi 5 dhe 142 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, dhe nga hyrja në fuqi e Ligjit për Minierat dhe Mineralet ( 03/L-163) vepron në përputhje me këtë ligj.

**Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)** është organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit .

**Organet tjera qeveritare**, siç janë Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, luajnë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e komponentëve tjera, ekonomike, mjedisore dhe sociale të sektorit mineral.

#### 3.1.2 Ndërmarrjet e sektorit

**“Trepça, nën Administrimin e AKP-se”,** është kompania trashëguese e ish kompleksit të ndërmarrjeve shoqërore Kombinati Xehëtar – Metalurgjik “Trepça”, që përbehet nga disa miniera, flotacione, metalurgjitë dhe industria kimike. Aktualisht janë funksionale me operime të kufizuara minerare, katër miniera (Miniera “Trepça” në Stanëterg, Miniera Cernac, Miniera Bello Berdo dhe Miniera Artana). Mbyllja e minierave në fillim të viteve ’90-ta dhe si pasojë edhe mbyllja e industrisë së bazuar në prodhimin mineral, ka ndikuar shumë në rritjen e shkallës së papunësisë. Është e njohur që më 1989, minierat e Trepçës punësonin rreth 7 mijë punëtorë, kurse i tërë Kombinati kishte të punësuar mbi 22.000 punëtorë. Aktualisht, afërsisht 2,500 persona janë të punësuar, ndërsa 2,500 të tjerë mbështeten me ndihmesa sociale të ulëta, të gjitha të financuara nga Buxheti i Kosovës. Në Trepçë janë kryer punë me rëndësi në vlerësimin e potencialit ekonomik (fizibiliteti) të operimit të minierave, dhe ato janë vlerësuar si profitabile<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> “ Studimi i fizibilitetit” për minierat Trepça dhe Artana, Qershor 2006. Dokumentacioni i Kompleksit “Trepça nën Administrim të AKP”.

Sipas ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me nenin 50 të Ligjit për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre, Ligji Nr. 04/L-035 që ka hyrë në fuqi më 26.10.2011, lidhur me Vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. SCR-05-001, të datës 09.03.2006, si dhe vendimit pasues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. SCR-05-001-R008, R009 dhe R011, të datës 19.05.2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall moratorium për Ndërmarrjet Thelbësore të Trepçës dhe Ndërmarrjet Tjera të Trepçës që kanë hyrë në fuqi nga data 8 Nëntor 2011.

Vendimi për Moratoriumin mbi Kompleksin Trepça nënkupton që prej datës 8 Nëntor 2011 të gjitha veprimet, procedurat dhe veprimet e çfarëdo lloji që kanë për qëllim përcaktimin e vlefshmërisë, zbatimin apo përmbushjen e kërkesave apo interesave lidhur me Trepçën, apo Pasurisë së sajë, pezullohen dhe mund të vazhdojnë vetëm me lejen e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit<sup>2</sup>

**Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.);** është kompani publike e Kosovës e cila ka në pronë dhe operon me asete të mihjes së linjitet, gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike. Në kuadër të KEK sh.a. gjendet Divizioni për Prodhimin e Qymyrit përgjegjës për këto veprimtari: prodhimi i qymyrit, transportimi i qymyrit, separacioni dhe deponimi para se qymyri të dërgohet në TC për djegie. Në minierat e qymyrit “Kosova”<sup>3</sup> në Mirash dhe Bardhë, deri në vitin 1990 kanë punuar 5,600 punëtorë, aktualisht në këto miniera punojnë rreth 3.600 punëtorë.

**NewCo Ferronikeli;** hulumtimet sistematike në Kosovë për zbulimin e vendburimeve të Ni-Co kanë filluar në vitin 1961. Shfrytëzimi i xehes së nikelit dhe përpunimi-shkrirja e xehes dhe përfitimi i aliazhit Fe – Ni Co, ka filluar në vitin 1984. Në kuadër të Ferronikelit kanë funksionuar dy miniera me shfrytëzim sipërfaqësorë (Çikatova dhe Gllavica), njësia e hulumtimeve gjeologjike dhe shkretorja. Gjatë viteve 1984-1999 janë shfrytëzuar 7,092,090 t xehe me 1.21% Ni, ndërsa nga viti 1984 gjerë në vitin 1997 janë prodhuar 36,728 t Ni metal. Pas vitit 1997 shkretorja e Ferronikelit nuk ka qenë në funksion.

Tregu evropian për ferronikelin e prodhuar nga shkretorja në Gllgovc është i njohur që nga prodhimet e para të tij. Rreth 90% të prodhimit është shitur në tregun evropian.

Në vitin 1990 në Ferronikel kanë punuar 1944 punëtorë, në vitin 1999 gjithsej 1424.

Ferronikeli është privatizuar në fund të prillit 2006, nga kompania IMR-Alferon, pas privatizimit në punë janë rreth 1000 punëtorë.

**Minierat e magnezitit Golesh dhe Strezovc;** para luftës miniera e magnezitit në Golesh – Magurë ka prodhuar magnez kaustik të qëndrueshëm ndaj zjarrit, për shfrytëzuesit nga ish-Jugosllavia, dhe ka eksportuar në vendet tjera të Ballkanit dhe Itali. Në minierën e Magurës, nga dokumentet arkivore të saj rezulton se nga viti 1964 e deri në vitin 1992 janë shfrytëzuar rreth 4,250,000 t magnezit. Shfrytëzimi i magnezitit nga miniera në Strezovc ka filluar në vitin 1956. Në vitin 1973 lëshohet në prodhim separacioni. Shfrytëzimi i resurseve të magnezitit është kryer me metoda sipërfaqësore dhe nëntokësore. Këto dy miniera janë privatizuar nga kompania “Iminggrup mgo” Sh.p.k. në vitin 2007.

Si pasojë e mos përmbushjes së kushteve të Marrëveshjes së privatizimit nga ana e blerësit (“Iminggrup mgo”) bordi i AKP-së në vitin 2010 ka marrë vendim për ndëshkimin financiar dhe atë; MIM Golesh me 6,357,094 €, dhe XIM Strezoc me 5,475,119 €. Pra, edhe pas procesit të privatizimit këto miniera nuk kanë arritur të konsolidohen dhe fillojnë prodhimin.

**Boksitet e Kosovës;** veprimtarinë e kanë filluar nga viti 1966, ku merren me shfrytëzimin e boksitit me metoda sipërfaqësore. Para mbylljes së minierës në vitin 1990 kjo minierë ka realizuar prodhim vjetor deri në 100,000 t boksit. Në vitin 1989 kjo minierë ka punësuar 596 punëtorë, kurse në vitin

2 Njoftim për Moratorium nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Departamenti Ligjor, Prishtinë, Nëntor 2011.

3 Korporata Energjetike e Kosovës-“Raporti i pyetësorit për minierat Bardh dhe Mirash”, Kastriot Prill 2006.

1999 pas luftës janë kthyer 340 punëtorë. Për shkak të humbjes së tregut, punëtorët e kthyer janë marrë me prodhimin e gurit gëlqerorë me synim të përgatitjes për shfrytëzimin e boksiteve. Kompania gjendet në fazën e privatizimit dhe nuk punon.

**Miniera e mergelëve “SharrCem;** ka funksionuar si kompani me përgjegjësi të kufizuar, e komercializuar në bazë të marrëveshjes në mes të UNMIK-ut dhe kompanisë Zvicerane Holcim për një periudhë kohore prej 13.06.2000 deri më 13.06.2010. Deri në vitin 2010 NSH “SharrCem” ka vepruar si ndërmarrje e komercializuar nën monitorimin e AKP-së.

Në vitin 2010, Bordi i drejtorëve i AKP-së, ka aprovuar privatizimin e ndërmarrjeve të komercializuara ndër të tjera edhe privatizimin e NSH “SharrCem”. Kapaciteti vjetor i prodhimit në fabrikë është 0.6 Mt çimento.

### 3.2. Korniza ligjore

Ligjet, aktet nënligjore dhe vendimet e mëposhtme të Qeverisë të cilat kanë apo mund të kenë ndikim në sektorin minerar

- Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet;
- Ligji nr. 2004/28 për punimet nga metalet e çmuara;
- Ligji Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike;
- Ligji nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme;
- Ligji Nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/l-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme;
- Ligji nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat;
- Ligji Nr. 03/L-184 për Energjinë;
- Ligji Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë;
- Ligji Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike;
- Ligji Nr. 03-L-133 për Gazin Natyror;
- LigjiNr. 03/L-116 për Ngrohje Qendrore;
- Ligji Nr. 2003/14 për Planifikimin Hapësinor;
- Ligji nr. 03/L-106 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003-14 për Planifikim Hapësinor;
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Ligji Nr. 04/-L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre;
- Ligji Nr. 04/L-033 për Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Ligji Nr. 2004/42 për Veprimtarinë Kërkimore Shkencore;
- Ligji Nr. 02/L-33për Investimet e Huaja;
- Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës
- Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
- Ligji Nr. 02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare;
- Ligji Nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/l-123 për Shoqëritë Tregtare;

- 
- Ligji Nr. 03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës;
  - Udhëzim Administrativ Nr. 01./2011 për Rregullat dhe Procedurat e Mbledhjes së Rentës Minerare;
  - Rregullore Nr. 02/2011 për Përmbajtjen e Programit të Hulumtimeve Gjeologjike dhe Elaboratit të Rezultateve të Hulumtimeve Gjeologjike;
  - Rregullorja Nr. 04/2011 për Trajtimin e Komunitetit në Sektorin Minerar;
  - Rregullorja Nr. 05/2011 për Organizimin dhe Funksonimin e Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve;
  - Rregullorja Nr. 06/2011 për Sigurinë Minerare;
  - Vendimi i Qeverisë për politikën e pronësisë për NP Qendrore nr. 11/39 dhe nr. 13/39;
  - Vendimi i Qeverisë për ristrukturim të KEK sha, nr. 06/2005;
  - Vendimi i Qeverisë për shthurje të KEK sha, nr. 04/36, 2008;
  - Vendimi i Qeverisë nr. 02/46 i datës 02.11.2011 për ndalimin e shfrytëzimit të materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat për rreth lumenjve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

---

## 4. GJENDJA DHE POTENCIALI I SEKTORIT MINERAR

### 4.1. Resurset minerare<sup>4</sup>

Territori i Republikës së Kosovës karakterizohet me një ndërtim kompleks gjeologjik. Këtë e dëshmojnë numri i madh i formacioneve gjeologjike nga ato më të vjetrat e deri më sot.

Shumëllojshmëria e formacioneve, veprimtaria intruzive dhe efuzive, efektet e sedimentimit dhe tektonika kanë ndikuar që në territorin e Republikës së Kosovës të formohen shumë lloje të mineraleve dhe vendburimeve të rëndësishme të resurseve minerare energjetike, metalore dhe jo metalore.

#### 4.1.1 Mineralet Energjetike

Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe statusit të rezervave të burimeve minerale energjetike, Republika e Kosovës në territorin e vetë disponon me rezerva të konsiderueshme të qymyrit të tipit linjit, sasi të vogël të mineraleve radioaktive.

##### 4.1.1.1 Qymyri

Qymyri (Linjiti) është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës, i cili furnizon rreth 97% të prodhimit total të energjisë elektrike.

Hulumtimet e para të qymyrit në Kosovë kanë filluar në fillim të shekullit XX ku është konstatuar se në Kosovë ekzistojnë rezerva të mëdha të qymyrit. Në vitin 1922 fillon shfrytëzimi nëntokësor në minierën e Hadës e më vonë edhe në Babush të Lipjanit. Hulumtimet sistematike gjeologjike të qymyrit në basenin e Kosovës, kanë filluar në periudhën kohore 1952-1957. Gjatë kësaj periudhe është bërë përgatitja për kalimin e shfrytëzimit të qymyrit në basenin e Kosovës, nga shfrytëzimi nëntokësor në atë sipërfaqësor duke shqyrtuar mundësitë e shfrytëzimit masiv për nevojat e termocentraleve për prodhimin e energjisë elektrike dhe përpunimin industrial të qymyrit.

Qëllimi kryesor i këtyre hulumtimeve ka qenë njohja me shtrirjen, formën, moshën dhe tektoniken e baseneve qymyrbajtëse e në veçanti për vlerësimin e kualitetit dhe trashësisë së shtresës së qymyrit.

Basenet më të rëndësishme qymyrbajtëse janë:

- Baseni i Kosovës;
- Dukagjinit; dhe
- Drenicës.

---

4 Shtojca 1- Përmbledhje më të dhëna për resurset kryesore minerale të Kosovës.




Fig. 1 Basenet qymyrbajtëse të Kosovës

Resurset e vlerësuara<sup>5</sup> të linjtit në gjithë Kosovën janë dhënë në tabelën1.

Tabela 1. Rezervat qymyrit në Republikën e Kosovës

Basenet qymyrbajtëse	REZERVAT (t)		
	Gjeologjike	Bilance*	Jo bilance**
<b>Kosovës</b>	10, 091, 000,000	8,772,000,000	1,319,000,000
<b>Dukagjinit</b>	2, 244, 830,000	2,047,700,000	197,130,000
<b>Drenicës (f. Skenderaj)</b>	106, 631,000	73,188,000	33,443,000
<b>Gjithsejtë</b>	<b>12,442,461,000</b>	<b>10,892,888,000</b>	<b>1,549,573,000</b>

## Baseni qymyrbajtës i Kosovës

Baseni qymyrbajtës i Kosovës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës. Në aspektin gjeomorfologjik dhe gjeografik, pellgu i Kosovës paraqitet si ultësirë tipike, boshti gjatësor i të cilës shtrihet në drejtim Veri Veri-Perëndim - Jug Jug-Lindje, duke filluar nga Mitrovica në veri gjerë në Kaçanik në jug. Gjatësia e pellgut të Kosovës është rreth 85 km, ndërsa gjerësia mesatare e këtij pellgu është rreth 10 km. Ky pellg zë një sipërfaqe prej rreth 850 km<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja e basenit qymyrbajtës të

<sup>5</sup> Klauzola reviduese nr. 152, Universiteti i Prishtinës, 2008, lidhur me –“Studimi për Vlerësimin e hulumtimeve dhe rezervave gjeologjike të qymyrit në Kosovë”, Baseni i Kosovës, Prishtinë 2007, fq. 81. Instituti Inoks

\* Rezervat bilance janë ato rezerva ku fuqia kalorike e qymyrit është mbi 5.450 kJ/kg

\*\* Rezervat jashtë bilance janë ato rezerva ku fuqia kalorike e qymyrit është nën 5.450 kJ/kg



Kosovës (pjesa produktive) zë një sipërfaqe rreth 300 km<sup>2</sup>.



Fig. 2. Baseni qymyrbajtës i Kosovës

Baseni qymyrbajtës i Kosovës ka një rrjet të zhvilluar të komunikacionit rrugor, hekurudhor dhe ajror, me të cilat Republika e Kosovës lidhet me të gjitha shtetet në regjion dhe më gjerë. Në aspektin mineral, kjo infrastrukturë rrugore dhe e komunikacionit hekurudhor, ka një rëndësi të veçantë, ngase gjatë shfrytëzimit të qymyrit duhet të parashikohen edhe zgjidhjet për zhvendosjen e tyre, veçanërisht nëse shtrihen mbi fushat e shfrytëzueshme të qymyrit.

Në aspektin gjeologjik, baseni i Kosovës, lokalizohet brenda serisë së fuqishme të Pliocenit, e cila për nga përbërja petrografike dhe karakteristikat faciale, tregon ndryshueshmëri të shumta. Trashësia e kësaj serie, në pjesët e veçanta, ka ndryshime në diapazone relativisht të gjëra si rrjedhojë e morfologjisë së paleoreliefit dhe kushteve të tjera të proceseve të sedimetimit.

Në bazë të hulumtimeve gjeologjike të gjertanishme, në basenin qymyrbajtës të Kosovës, është përcaktuar vetëm një shtresë qymyrore me ndërtim të ndërlëkuar dhe me ndërfutje, kryesisht të argjilave dhe karbonateve. Prania e ndërfutjeve, posaçërisht në pjesët periferike të basenit, shpesh krijon përshtypje të gabuar për praninë e më shumë shtresave të qymyrit. Materiali i shtresës qymyrore është i ndërtuar kryesisht prej qymyrit ksilit dhe qymyr dheut. Të dy këto lloje të qymyrit paraqitën së bashku, me proporcione të ndryshme.

Baseni i Kosovës, në krahasim me shumë basene qymyrore të kualitetit të ngjashëm (lloji i linjtit), është në përparësi ekonomike dhe minerare – shfrytëzuese, nga se brenda kufirit gjeologjik sasia e tërësishme e djerrinës/mbulesës është 15,857,000 000 m<sup>3</sup>, që paraqet një raport të volitshëm djerrinë/qymyr 1.76 m<sup>3</sup>/m<sup>3</sup>.

Sipas të dhënave të KEK sh.a., shfrytëzimi i gjertanishëm i qymyrit nga mihjet sipërfaqësore Bardh dhe Mirash, kryesisht për nevojat e energjetike, ka filluar nga viti 1958. Deri në fund të vitit 2011, janë nxjerrë gjithsej 308,216,542 ton linjit. Gjithashtu, qymyri në basenin e Kosovës nga viti 1922 e përfundimisht deri në vitin 1958 është shfrytëzuar edhe me metoda nëntokësore, ku gjatë kësaj periudhe kohore janë nxjerr rreth 9,100,000 ton.

Sipas referencave<sup>6</sup> kostoja mesatare e nxjerrjes së qymyrit për basenin e Kosovës vlerësohet të jetë (7.8 deri 11 €/ton).

Kostoja mesatare e nxjerrjes (kostoja operuese) është kategori dinamike e cila do të përcaktohet me planet operative vjetore për fushën gjejiqëse shfrytëzuese.

*Vendbanimet në Basenin qymyrbajtës të Kosovës.* Në analizën e përgjithshme të bëre gjerë tani në basenin e Kosovës vend të rëndësishëm zënë edhe vendbanimet me popullimin e saj. Mbi basenin e Kosovës shtrihen 68 vendbanime që i takojnë pesë komunave: Vushtrrisë, Obiliqit (Kastriotit), Fushë Kosovës, Prishtinës, dhe Lipjanit.

Në bazë të aero incizimit të vitit 2004 është konstatuar se shtrirja e vendbanimeve mbi basenin qymyrbajtës të Kosovës zënë një sipërfaqe prej 35.65 km<sup>2</sup>, gjegjësisht nëse i shtohet edhe hapësira eventuale për brezin e sigurisë rreth këtij baseni me qëllim të shfrytëzimit të tërë, atëherë kufiri i definuar, zgjerohet në 43.31 km<sup>2</sup>.

## Baseni qymyrbajtës i Dukagjinit

Pellgu i Dukagjinit në kuptim të gjerë paraqet njësi të veçantë morfo-tektonike në tërësi të formuar mbi struktura shumë të komplikuar më të vjetra. Boshiti i pellgut ka shtrirje meridionale me anim në drejtim Verilindje-Jugperëndim. Sipërfaqja e tërë pellgut është rreth 1,700 km<sup>2</sup>. Lumi, Drini i Bardhë rrjedh pothuajse për mes të pellgut.

Pellgu i Dukagjinit ka lidhje të mira të komunikacionit. Në anën jugore kalon hekurudha Fushë Kosovë – Pejë me një degë që shpie për Prizren. I tërë pellgu përshkohet me rrugët e asfaltuara Pejë – Gurakoc – Mitrovicë, me rrugën Pejë – Klinë – Prishtinë, me rrugët e asfaltuara Gurakoc – Istog dhe Gurakoc – Klinë. Nuk mungojnë edhe rrugët e kategorive dytësore që shpijnë për gjatë fshatrave për rreth, dhe shumë nga këto janë të asfaltuara.

Meqenëse pellgu i Dukagjinit ka një rrjet të zhvilluar të komunikacionit rrugor dhe hekurudhor gjatë shfrytëzimit të qymyrit duhet të parashikohen edhe zgjidhjet për zhvendosjen e atyre objekteve infrastrukturore të cilat shtrihen brenda fushave shfrytëzuese.

<sup>6</sup> RWE - "Alokimi i resurseve të linjimit", Prishtinë 2006, sipas Studimit, kostoja e shfrytëzimit të një ton linjit sillet prej 7.8-11 €/ton.




Fig. 3. Baseni qymyrbajtës i Dukagjinit

Baseni qymyror i Dukagjinit shtrihet pothuajse në pjesën qendrore të pellgut të Dukagjinit. Sipas shkallës së hulumtimeve, hapësira e tërësishme hulumtuese është nda në pesë (5) fusha, nga veriu në jug:

- Fusha “Tuçep”
- Fusha “C”
- Fusha “B”
- Fusha “A” dhe
- Fusha “Klinë – Kusar”, që zënë një sipërfaqe në total prej 49 km<sup>2</sup>.

Hulumtimet e qymyrit në basenin qymyrbajtës të Dukagjinit, në periudhën e pas luftës së dytë botërore, fillojnë me fazën e kërkimeve të përgjithshme gjeologjike dhe studimeve për përpilimin hartave gjeologjike. Përpilimi i hartave gjeologjike është bërë me qëllim të sigurimit të dhënave themelore dhe për planifikimin e hulumtimeve në të ardhmen.

*Vlerësimet për basenin e Dukagjinit.* Baseni qymyrbajtës i Dukagjinit karakterizohet me një shkallë më të ulët të hulumtimeve gjeologjike në krahasim me basenin e Kosovës, kështu që shtrohet nevoja për hulumtime gjeologjike komplekse. Hulumtimet gjeologjike duhet të vazhdojnë në drejtim të qytetit të Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit nga se indikacionet e hulumtimeve gjeologjike paraprake në këto

drejtime janë inkurajuese.

Hulumtimet e gjertanishme, edhe pse të kufizuara në sasi dhe në hapësirë, kanë ofruar të dhëna preliminare për llogaritjen e rezervave<sup>7</sup>, që janë pasqyruar në tabelën 1. Nga rezultatet e hulumtimeve të gjertanishme është konstatuar vëllimi i tërësishëm i djerrinës prej 5,916,000,000 m<sup>3</sup>. Raporti djerrin/qymyr për rezervat gjeologjike është 3.24 m<sup>3</sup>/m<sup>3</sup> kurse për rezervat bilance 3.37 m<sup>3</sup>/m<sup>3</sup>.

Qymyri në basenin e Dukagjinit i takon grupit të qymyreve të reja dhe të buta-linjit, të tipit ksilit. Shtresa e qymyrit në basenin e Dukagjinit ka një trashësi mbi 52m, në anën veriore, lindore dhe jugore, ndërsa me trashësi më të vogël se 20m në periferitë e basenit, sidomos në anën verilindore të basenit.

*Vlerësimi ekonomik i basenit të Dukagjinit.* Në bazë të analizave të gjertanishme dhe duke i vënë në krahasim basenet qymyrmbytëse të Kosovës dhe të Dukagjinit, mund të konstatohet që në basenin e Dukagjinit mungojnë aktivitetet minerare dhe do të duhej një analizë më e thelluar për zhvillimin e këtyre aktiviteteve duke i konsideruar të gjitha ndikimet e mundshme, posaçërisht nga aspekti i ndikimit ekonomik - agrar në regjion.

*Vendbanimet në Basenin e Dukagjinit.* Në basenin e Dukagjinit (pjesa e hulumtuar) ekziston numër i konsiderueshëm i vendbanimeve. Mbi vendburimin qymyror të basenit të Dukagjinit shtrihen, 19 vendbanime që i takojnë Komunave të Istogut dhe Klinës.

Në bazë të evidencës që rezulton nga aero incizimi i kryer në vitin 2004 është llogaritur sipërfaqja e përgjithshme e vendbanimeve të cilat shtrihen mbi basenin qymyrmbytës të Dukagjinit dhe që arrijnë sipërfaqen totale prej 5.83 km<sup>2</sup>.

## Baseni qymyrmbytës i Drenicës

Baseni qymyrmbytës i Drenicës shtrihet ndërmjet basenit të Kosovës në lindje dhe basenit të Dukagjinit në perëndim. Basenin e karakterizojnë dy fusha: Fusha e Skenderajt në veri me sipërfaqe prej 3.97 km<sup>2</sup> dhe fusha e Gllabarit-Gllogovcit në jug, me sipërfaqe prej 1.5-2.0 km<sup>2</sup>.

Baseni ka një shtrirje në drejtim të meridianëve, me një devijim të butë kah perëndimi dhe ka një gjatësi të përgjithshme rreth 30 km dhe gjerësi maksimale rreth 10 km.

Lidhjet e komunikacionit të vendburimit me qendrat tjera janë të mira. Vendburimi i qymyrit me fushat Skenderaj dhe Gllogovc nëpërmjet rrugës së asfaltuar Skenderaj– Gllogovc lidhet me rrugën magjistrale Prishtinë – Pejë dhe Mitrovicë – Podgoricë, ndërsa Gllogovci ka lidhje hekurudhore Prishtinë – Pejë.

Në aspektin hidrografik të gjitha ujërat e pjesës veriore të basenit të Drenicës rrjedhin në lumin Klina i cili derdhet në lumin Drini i Bardhë.

7 Klauzola reviduese nr. 152 Universiteti i Prishtinës, 2008, lidhur me –“Studimi për Vlerësimin e hulumtimeve dhe rezervave gjeologjike të qymyrit në Kosovë”, Baseni i Kosovës, Dukagjinit dhe Drenicës, Prishtinë 2007. Instituti Inoks.




Fig. 4. Baseni qymyrbajtës i Drenicës (fusha Skenderaj dhe f. Drenas)

Në basenin e Drenicës hulumtimet e para gjeologjike me shpime kërkimore kanë filluar në vitin 1955. Gjatë vitit 1965 në fushën Gllobar–Drenas kanë vazhduar hulumtimet gjeologjike ku është vërtetuar prania e qymyrit në këtë basen, gjegjësisht është zbuluar shtresa kompakte e qymyrit të kualitetit ksilit.

Fusha qymyrore e Skenderajt është hulumtuar gjatë viteve 1965 dhe 1980.

*Vendburimi në basenin e Drenicës (Fusha Skenderaj).* Në bazë të rezultateve të hulumtimeve gjeologjike është bërë përcaktimi i kufirit të vendburimit dhe llogaritja e rezervave të qymyrit në vendburim. Trashësia e djerrinës/mbulesës është rreth 35 m, trashësia mesatare e shtresës së qymyrit është rreth 23 m.

Në bazë të llogaritjeve që janë bërë, rezervat gjeologjike në basenin e Drenicës (Fusha e Skenderajt) janë dhënë në Tabelën 1.

Për të njëjtën fushë, masat e djerrinës/mbulesës janë  $69,503,000 \text{ m}^3$ , ku raporti djerrin/qymyr për rezervat gjeologjike është  $0,76 \text{ m}^3/\text{m}^3$ , ndërsa për rezervat bilance është  $1,08 \text{ m}^3/\text{m}^3$ .

*Kualiteti i qymyrit.* Në bazë të dhënave gjeologjike të paraqitura në elaboratin gjeologjik të rezervave të qymyrit për fushën e Skenderajt<sup>8</sup>, vlera maksimale e kualitetit të qymyrit është në pjesën jugore–qendrore  $9,213 \text{ kJ/kg}$  dhe mesatare  $7,117 - 7,955 \text{ kJ/kg}$ , ndërsa vlera minimale e kualitetit të qymyrit është  $4,188 \text{ kJ/kg}$ , në pjesën lindore.

8 Klauzola reviduese nr. 152 Universiteti i Prishtinës, 2008, lidhur me –“Studimi për Vlerësimin e hulumtimeve dhe rezervave gjeologjike të qymyrit në Kosovë”, Baseni i Kosovës, Dukagjinit dhe Drenicës, Prishtinë 2007. Instituti Inoks.

## Paraqitjet tjera

Perspektiva për zbulimin e vendburimeve të reja të qymyrit është e volitshme dhe reale, meqenëse ekzistojnë parakushte të mira gjeologjike. Ka indikacione që qymyri të paraqitet edhe në më shumë lokacione tjera. Paraqitjet dhe indikacionet në basenin e Dukagjinit që janë zbuluar më herët, duke pas parasysh hulumtimet e pakta që janë bërë në këtë basen premtojnë vendburime të reja të qymyrit, sidomos në pjesën jugore të ultësirës së Pejës, në pjesën e Gjakovës dhe të Prizrenit.

Një prej lokacioneve potenciale është baseni Neogjen i Krivarekës, i cili paraqet një pellg tektonik i formuar në pjesët kufitare të Masivit Dardan (MD) në lindje dhe zonës së Vardarit në perëndim. Trashësia e shtresës së qymyrit në këtë zonë arrin deri në 5 m. Hulumtimet në këtë basen kanë qenë simbolike.

## Mihjet sipërfaqësore ekzistuese Mirash-Bardh

Prodhimi i qymyrit nga mihja sipërfaqësore e Mirashit ka filluar në vitin 1958, ndërsa nga mihja sipërfaqësore e Bardhit në vitin 1969. Këto dy mihje sipërfaqësore janë të hapura, të zhvilluara dhe gjinden në fazën përfundimtare të shfrytëzimit. Aktualisht këto miniera përbëjnë një fushë të përbashkët shfrytëzimi. Shfrytëzimi në këto miniera pritet të përfundoj në vitin 2012.

Kapaciteti prodhues vjetor për të dy mihjet ka qenë 28.000.000 m<sup>3</sup> djerrinë (masë e fortë) dhe rreth 17.000.000 ton qymyr. Prodhimtaria maksimale nga këto dy mihje është realizuar në vitin 1988 dhe atë në djerrinë 20.830.450 m<sup>3</sup> dhe qymyr 10.619.869 ton.

Që nga viti 2010, qymyri është duke u prodhuar edhe nga “Mijha e Re” (Sibovci Jug-Perëndim), mihje kjo e cila është në zhvillim e sipër.

### 4.1.1.2 Urani

Hulumtimet gjeologjike të uranit janë realizuar gjatë viteve të gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar dhe kanë përfshirë pjesën lindore dhe verilindore të Kosovës. Punimet kërkimore me prospektim regional radiometrik si dhe me matje adekuate gjeofizike, i ka kryer kompania Geozavod, e cila edhe i posedon shënimet e plota për rezultatet e këtyre hulumtimeve. Sipas të dhënave të publikuara nga kompania kërkimore, me këto hulumtime është konstatuar një damar uran-bartës në trahite që është i pasuruar me uran dhe torium. Trashësia mesatare e damarit është rreth 1,4 metra, damari është konstatuar dhe është përcjellë në rënie dhe në shtrirje deri në 64 metra në thellësi dhe përmbajtja e uranit sillet nga 0,02- 0,16%.

Në Kosovë ekzistojnë edhe shumë formacione gjeologjike që sot konsiderohen si potenciale (granitoidet, vullkanitet sidomos ato alkaline, sedimentet permo-triasike, basenet terigjene terciare etj.), në të cilat do të duhej të orientohen hulumtimet e ardhshme.

Shënim: Hulumtimi, balancimi dhe shfrytëzimi eventual i resurseve radioaktive mbetet përgjegjësi e shtetit të Kosovës që në harmoni me rregullat ndërkombëtare të kujdeset për evaluimin e plotë të tyre.

### 4.1.1.3 Resurset tjera (Nafta dhe Gazi)

Hulumtimet e naftës dhe gazit në Republikën e Kosovës kanë filluar në vitin 1963-1968 nga ana e Naftagasit (Novisad), kurse më vonë ka shfaqë interes për hulumtime strukturore gjeologjike në këtë fushë edhe kompania INA (Zagreb). Ato kanë rezultuar me përcaktimin e gjashtë njësive strukturore tektoniko-faciale, si potenciale për paraqitjen e hidrokarbureve. Posaçërisht është veçuar njësia e pjesës veriore të basenit të Dukagjinit, me konstatim të nevojës për vazhdimin e hulumtimeve të cilat do të rezultonin me vlerësimin e mundësisë së pranisë së naftës dhe gazit në Kosovë<sup>9</sup>.

### 4.1.2 Mineralet metalore

#### 4.1.2.1 Plumbi (Pb), Zinku (Zn) dhe Argjendi (Ag)

Vendburimet dhe paraqitjet më të rëndësishme të plumbit dhe zinkut gjenden në të ashtuquajturin “Brezin Metalogjenik të Trepçës”, i cili shtrihet në pjesën verilindore të Republikës së Kosovës, duke filluar nga Leposaviqi gjerë në Gllamë (Gjilan). Gjatësia e brezit është mbi 80 km, kurse gjerësia mesatare është rreth 30 km.

Në Republikën e Kosovës dallojmë një numër të caktuar të minierave të zhvilluara (minierat kyçe), si dhe një numër i vendburimeve më parë të vlerësuara, por të pazhvilluara. Miniera të zhvilluara (kyçe) janë: miniera “Trepça” në Stantërg, Hajvalia, Badofci, Kizhnica, Artana, Belloberda dhe Cërnaci.

Paraqitjet dhe vendburimet më të rëndësishme (më parë të hulumtuara dhe të vlerësuara) janë: Melenica, Zjaqa, Magjera, Gjidoma, Tërstena, Rashani, Vidishiqi, Mazhiqi dhe Gumnishta në zonën e Stantërgut, Quka e Batllavës në juglindje të Podujevës; Kaltërina e Përroi i Ngjyrosur në zonën e Artanës, si dhe Kallugjerica dhe Gomile, në pjesën veriore të Kosovës. Për vendburimin e zinkut dhe plumbit në Cërpulë, në jugperëndim të Mitrovicës nevojiten hulumtime intensive, pasi hulumtimet e mëparshme kanë dhënë rezultate të favorshme.

## Vendburimet kryesore

### Stantërgu

Ndërtimi gjeologo-tektonik i zonës metalogjenike të Stantërgut me rrethinë është kompleks, me prezencën e trupave masivë të xeheve sulfite me rëndësi ekonomike, ku raporti Pb / Zn është rreth 1.4 : 1.0.

Vendburimet minerale në Stantërg dhe më gjerë, janë hulumtuar nga viti 1924, punimet minerare të hapjes së minierës kanë filluar në vitin 1927, kurse shfrytëzimi i xeheve nga kjo minierë ka filluar nga muaji tetot i vitit 1930. Prodhimi i xeheve nga miniera Trepça në Stantërg është realizuar në kontinuitet, me një shkëputje të vogël rreth 8 mujore në vitin 1945. Dhe ka vazhduar deri në vitin 1991, kur miniera praktikisht mbyllet, pas largimit të punëtorëve shqiptarë me dhunë nga puna.

Rezervat gjeologjike në minierën “Trepça” janë të hulumtuara mirë dhe praktikisht çdo trup xeheror është i “prekur” me punime minerare dhe i mostruar. Mostrat të cilat janë marrë nga disa punishte në horizontin X (dhjetë) gjatë vitit 2003, dhe që janë analizuar në laboratorin OMAC në Irlandë, kanë treguar rezultate të kualitetit shumë më të lartë se që janë shënimet në elaboratet gjeologjike të mëhershme. Këto fakte e ngritin besueshmërinë e rezervave të Stantërgut.

<sup>9</sup> Boksitet e Kosovës - “Raporti i pyetësorit për miniera”, Klinë, Prill.2006.



Nga eksperiencia e akumuluar si dhe në bazë të rezultateve të hulumtimeve gjeologjike, për këto vendburime ekzistojnë studime, si në aspektin e gjeometrisë së trupave, cilësisë së xehes, flotabilitetit të mineraleve, strukturës së lidhjeve metalore dhe teksturës së ndërtimit të kompozimeve xeherore, etj<sup>10</sup>. Zona metalogjenike e minierës “Trepça”, përbëhet prej vendburimit kryesor mbi të cilin është hapë miniera aktuale, dhe nga disa vendburime më të vogla. Këto vendburime, kanë shkallë të ndryshme të hulumtimit, mirëpo nga aspekti i strukturës xeherore polimetalore, janë të njëjta apo të ngjashme me xehen e vendburimit amë.

Miniera Trepça ka një infrastrukturë moderne sipas modelit bashkëkohor të minierave nëntokësore, i ka tri puse servili dhe të ajrosjes, është e zhvilluar në 12 horizonte, kurse ndërmjet tri horizonteve të fundit janë zhvilluar rampat që mundësojnë aplikimin e mekanizimit bashkëkohor në përgatitje dhe në shfrytëzim të xehes. Miniera me infrastrukturën e vetë si dhe me metodat bashkëkohore të mbushjes, ka kapacitetin e shfrytëzimit të xehes prej 500.000 deri në 650.000 ton xehe në vit. Arritja e kapacitetit të plotë të minierës është e kushtëzuar me numrin e duhur të punëtorëve si dhe me investimet e parapara për freskimin e mekanizimit dhe eliminimin e “fyteve të ngushta”.

Zona metalogjenike e minierës “Trepça”, përveç vendburimit kryesor, karakterizohet edhe me një numër të vendburimeve në rrethinë, të cilat kanë shkallë të ndryshme të hulumtimeve të realizuara gjeologjike.

Ndër këto, si lokacionet më perspektive dhe më me interes janë ato që shtrihet në trekëndëshin e fshatrave Rashan – Tërstenë – Gumnishtë. Definimi i plotë i rezervave në këtë lokacion, kërkon hulumtime shtesë, si nga miniera ekzistuese e Trepës (Koridoret M1, M3 dhe M5), ashtu edhe nga sipërfaqja.

Rezervat sipas lokacioneve në regjionin e Stantërgut janë dhënë në tabelën 2.

Tabela 2: Rezervat sipas lokacioneve në regjionin e Stantërgut<sup>11</sup>

Nr	Miniera -Lokaliteti	Sasia e x. (t)	Kualiteti (%)		Ag (g/t)	Metali (t)		(kg) Ag
			Pb	Zn		Pb	Zn	
1.	Stantërg	20,754,000	4.02	4.02	76.0	834,311	674,505	1,577,304
2.	Melenica	2,552,000	5.80	5.80	85.0	148,016	107,184	216,920
3.	Magjera	600,000	3.80	3.80	72.0	22,800	18,000	43,200
4.	Mazhiq-Maja Madhe	1,500,000	3.30	3.30	60.0	49,500	42,000	90,000
5.	Gjedomë- Mazhiq	2,000,000	3.30	3.30	60.0	66,000	56,000	120,000
6.	Rashan- Tërstenë	2,500,000	3.30	3.30	60.0	82,500	70,000	150,000
7.	Zjaqë	5,175,000	2.83	2.83	16.0	146,453	112,815	82,800
<b>8.</b>	<b>TOTAL</b>	<b>35,081,000</b>	<b>3.85</b>	<b>3.85</b>	<b>65.0</b>	<b>1,349,579</b>	<b>1,080,504</b>	<b>2,280,224</b>

Miniera e Stantërgut me vendburimet që e rrethojnë, ka rezerva prej rreth 35 Mt, ose shprehur përmes sasisë të metaleve në xehe, 1,349,579 ton plumb, 1,080,504 ton zink dhe 2,280,224 kg argjend<sup>12</sup>, dhe aktualisht paraqet një nga potencialet më të rëndësishme të xeheve sulfite të Pb dhe Zn në regjion.

10 Dokumentacioni i Minierës me flotacion, Trepça-Artana - “Studimi i fizibilitetit”, Qershor 2006

11 Rezervat e xehes si resurse (pa kategorizim) në minierat e Trepçës, Mitrovicë, 2012

12 Rezervat e xehes si resurse (pa kategorizim) në minierat e Trepçës, Mitrovicë, 2012

## Kompleksi i minierave (Artanë, Hajvali, Badovc, Kizhnicë)

Kompleksi i minierave Artanë, Hajvali, Badovc, Kizhnicë, shtrihet në sipërfaqe të gjerë në pjesën lindore të Republikës së Kosovës. Këto vendburime janë tipike polimetalore dhe karakterizohen me përbërje të lartë të metaleve të çmueshme të arit (Au) dhe argjendit (Ag).

Zona metalogjenike e kompleksit të minierave të plumb-zinkut Artanë – Kizhnicë – Hajvali dhe Badovc, shtrihet në një sipërfaqe rreth 400 km<sup>2</sup>, në territoret e disa komunave: Graçanicë (minierat Hajvalia, Badovci, Kizhnica dhe flotacioni në Kizhnicë), Artanës, (miniera Artana dhe fushat mineralmbajtëse Përroi i Thartë dhe Kaltrina) dhe Podujevës (miniera në hapje “Çuka e Batllavës”).

Në tërë rajonin mineralmbajtës të Artanës, Hajvalisë, Badovcit dhe Kizhnicës, përfshirë këtu edhe vendburimet që e rrethojnë, janë evidentuar rezervat e xehes prej 16,037,342 ton, me përbërje mesatare të Pb - 4.67 %, Zn - 6.52 % dhe Ag – 89.91 g/t, ose shprehur përmes sasisë së metaleve në xehe, në këto vendburime janë 749,354 t plumb, 1,045,444 t zink dhe 1.441.879 kg argjend<sup>13</sup>.

## Kompleksi i minierave Bello Bërdë / Cërnac

Minierat Cernac dhe Belo bordo shtrihen në pjesën veriore të Kosovës, kurse flotacioni i përbashkët i këtyre minierave është i vendosur në Leposaviq. Miniera në Bello Bërdë përfshin tre trupa xeherorë, raporti Pb / Zn është rreth 1.2 : 1.0.

Mineralizimet e plumbit dhe zinkut në zonën e vendburimit të minierës së Cërnacit përfaqësohen me prezencën e një serie damarësh, trashësia e të cilave shkon nga 0.5 m deri në 20 m, dhe ky ndryshim intensiv i trashësisë së damarëve është shkak i varfërimeve të mëdha (mine dilution) që paraqiten në xehen e prodhuar (ndërmjet 45% deri në 55%), edhe pse xehja primare në vendburim është e pasur dhe me raportin Pb / Zn me rreth 2.3:1.0.

Në total, kompleksi i minierave Bello Bërdë / Cërnac që shtrihen në rrethinën e komunës Albanik (Leposaviq), kanë totalin e rezerva ve të xehes prej 7.55 Mt<sup>14</sup>, me përbërje mesatare të metaleve në xehe Pb - 6.85 %, Zn - 5.07 % dhe Ag – 96.13 g/t, ose shprehur përmes sasisë së metaleve në xehe, në këto vendburime janë 516,645 t plumb, 382,373 t zink dhe 725,256 kg argjend.

## Rezervat/resurset në vendburimet kryesore shikuar në total

Në tërësi vendburimet e Trepçës nuk mund të raportohen në mënyrë kumulative përmes një tablele. Bazuar në të dhënat e fundit<sup>15</sup>, me qëllim që të pasqyrohet potenciali real gjeologjik i Trepçës, është bërë mbledhja fizike e të dhënave nga lokacionet të paraqitura në tabelën 3.

Tabela 3: Vendburimet kryesore të Plumb-Zinkut (argjendit) me rezervat kryesore<sup>16</sup>

Lokacioni	Xehe (t)	Pb (%)	Zn (%)	Ag(g/t)	Pb (t)	Zn (t)	Ag (kg)
Stantërgu	35,081,000	3.85	3.85	65.0	1,349,579	1,080,504	2,280,224
Cërnac/BB/Gom	7,544,227	6.85	5.07	96.13	516,645	382,373	725,256
Kompl. Artanë/ÇB	16,037,227	4.67	6.52	89.91	749,354	1,045,444	1,441,879
<b>TOTAL</b>	<b>58,662,569</b>	<b>4.46</b>	<b>4.28</b>	<b>75.81</b>	<b>2,615,578</b>	<b>2,508,321</b>	<b>4,447,359</b>

13 Rezervat e xehes si resurse (pa kategorizim) në minierat e Trepçës, Mitrovicë, 2012

14 Rezervat e xehes si resurse (pa kategorizim) në minierat e Trepçës, Mitrovicë, 2012

15 Rezervat e xehes si resurse (pa kategorizim) në minierat e Trepçës, Mitrovicë, 2012

16 Rezervat e xehes si resurse (pa kategorizim) në minierat e Trepçës, Mitrovicë, 2012

Siç mund të vërehet nga të dhënat tabelore, miniera e Stantërgut merr pjesë në rezervat totale të Trepçës me 59.80%, kurse në sasinë e tërësishme të metaleve (Pb+Zn), merr pjesë me 47.43%, çka është e kuptueshme kur konsiderohet shfrytëzimi intensiv i xehes nga kjo minierë në 8 dekadat e shkuara. Kompleksi i minierave të Artanës, Hajmalisë dhe Kishnicës, merr pjesë 27,34% në rezervat totale, kurse me sasinë e metaleve (Pb+Zn) merr pjesë me 35.02%. Minierat e zonës së Leposaviqit, marrin pjesë vetëm me 12.86% në rezervat totale të Trepçës, kurse në sasinë e tërësishme të metaleve pjesëmarrja arrin në 17.54%.

Përveç metaleve bazë (plumbit dhe zinkut), xehet e zonës metalogjenike të Trepçës karakterizohen me përmbajtje të lartë të argjendit i cili kryesisht koncentrohet në koncentratin e plumbit.

Xehet e Trepçës përbëjnë edhe metale tjera si ari (Au), Bi (bizmuth), Cd (kadmium), Se (selen), Te (Telur), In (indium), Ge (germanium), etj. Mirëpo, balancimi, koncentrimi dhe ndarja e tyre nuk bëhet në fazën e koncentrateve, por është i mundshëm vetëm në procesin e trajtimit metalurgjik të koncentrateve. Përbërja e Arit në xehe nuk bilancohet por të gjitha vendburimet në vete e përmbajnë edhe këtë metal i cili nxirret në fazën përfundimtare të përpunimit metalurgjik, me procesin e rafinimit. Llogaritjet që përmbajtja mesatare e arit në xehe është 0.8 gr/t.

*Prodhimi në të kaluarën.* Nga viti 1930 gjerë 1980, janë prodhuar këto sasi të xeheve, koncentrateve dhe metaleve në Kosovë: xehe Pb-Zn: 45.87 Mt, me 2.98 Mt Pb-koncentrat dhe 2.882 Mt Zn-koncentrat, Ag-2461 t, Bi-1860 t, Cd-827 t, Ari-10771 kg.

Nga viti 1979 deri më 1998, janë përpunuar 21.3 Mt xehe, me përmbajtje rreth 3.1 % Pb dhe 2.2 % Zn; janë prodhuar 649,000 t Pb dhe 442,500 t Zn. Për më shumë, janë nxjerrë 1,200 t Ag dhe 2,600 kg ari. Për një periudhë 70 vjeçare, vetëm Stantërgu ka prodhuar mbi 36 Mt xehe, mbi 2.1 Mt Pb, 1.4 Mt Zn dhe 3.6 t Ag.

#### 4.1.2.2 Nikeli (Ni) dhe Kobalti (Co)

Hulumtimet e mineraleve silikatë të nikelit në territorin e Kosovës datojnë që nga viti 1958, ku janë përcaktuar shfaqjet e para mineralizuese të nikelit në territorin e Gllavicës, afër minierës së magnezitit në Magurë. Në kuadër të Ferronikelit funksionojnë dy miniera me shfrytëzim sipërfaqësor: Gllavica dhe Çikatova (Dushkaja, Suka)

**Miniera e nikelit silikat “Gllavica”** gjendet në Jugperëndim të Prishtinës në distancë prej rreth 20 km. Vendburimi i nikelit Gllavica shtrihet në masivin peridotit të Goleshit në bregun lindorë të kodrës Gllavicë. Drejtimi i shtrirjes së vendburimit përafërsisht është Veri-Jug në gjatësi prej 1,050 m. Zona mineralmbajtëse shtrihet mbi peridotitet në formë të mbulesës dhe ka sipërfaqe prej rreth 32 ha. Vendburimi i nikelit “Gllavica”, i takon grupit të vendburimeve silikate të korës së tjetërsimit. Formimi i vendburimit është i lidhur me formimin e kores së tjetërsimit të serpentiniteve.

Pas hulumtimeve gjeologjike intensive gjatë vitit 1967, është zbuluar vendburimi i ri Çikatova afër Gllgovcit.

**Miniera e nikelit silikat “Çikatova e Vjetër”** gjendet në regjionin e masivit peridotit të Dritanit (Dobroshevcit) komuna e Gllgovcit. Nga Prishtina, në drejtim të perëndimit, gjendet në largësi prej 20 km, kurse nga vendburimi i Gllavicës është larg 12 km.

Në minierën e nikelit „Çikatovë e Vjetër“ ekzistojnë dy vendburime (trupa mineral): „Dushkaja“ dhe „Suka“. Rezervat gjeologjike në dy minierat (Gllavicë dhe Çikatovë) janë vlerësuar të jenë rreth 13 Mt me përbërje mesatare të nikelit 1.31% dhe të kobaltit 0.06%.<sup>17</sup>

Shfrytëzimi i xehes së nikelit ka filluar në vitin 1982, ndërsa shkëmborja ka filluar punën nga viti 1984.

<sup>17</sup> Shoqata e Inxhinierëve të Kosovës - “Zhvillimi i qëndrueshëm tekniko-teknologjik dhe mjedisi”, konferencë shkencore, Prishtinë 2002, fq 157-164 dhe Ferronikeli-“Raporti i pyetësorit për miniera”, Prishtinë 2006

Mes viteve 1982 - 1999, janë shfrytëzuar 7,092,090 ton xehe me 1.21 % Ni, ndërsa mes viteve 1984-1997 janë prodhuar gjithsej 36,728 ton nikel metal. Puna në minierat sipërfaqësore u ndërpre në vitin 1999 për shkak të luftës.

Sipas rregulloreve të UNMIK-ut, Ferronikeli është privatizuar me vendim të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, me metodën e “Spin-off”-it special. Pas privatizimit nga kompania NewCo Ferronikeli Complex L.L.C.- (prill, 2006), shfrytëzimi ka rifilluar në të dy minierat, gjatë vitit 2007.

#### 4.1.2.3 Boksitet

Regjioni boksit-bartës bën pjesë në masivin e shkëmbinjve ultrabazik të Rahovecit. Vendburimi dhe paraqitjet e boksitit shtrihen në Malin e Gremnikut, 5 deri në 10 km në juglindje të Klinës. Mineralizimi i boksiteve në këtë rajon është i lidhur me depozitimet karbonatike të Kretakut të sipërm në nivelin turonian-mastrihtian.

Boksiti i Kosovës i përket grupit të ferro-boksiteve, nga se kanë përmbajtje të lartë të hekurit, i cili konsiderohet i dëmshëm në procesin e përfutimit elektrometallurgjik të metalit Al. Rezervat e boksitit, janë rreth 2.7 Mt kurse rezervat e gurit gëlqeror përcjellës janë rreth 40 Mt<sup>18</sup>.

*Prodhimi në të kaluarën.* Miniera filloi punën në vitin 1966. Nga viti 1966 gjerë 1990 janë shfrytëzuar 3,255,615 t boksite. Nga fundi i viteve të '60-ta gjerë në fillim të '70-tave, prodhimi më i madh vjetor kalonte 200,000 ton/vit.

#### 4.1.2.4 Hekur-nikeli, kromi, mangani dhe bakri

Në Kosovë janë identifikuar një numër paraqitjesh dhe vendburimesh të vogla të hekurit, të cilat përmbajnë sasi të ndryshme të nikelit, kobaltit, kromit dhe bakrit. Paraqitjet dhe vendburimet e hekur – nikelit në Kosovë shtrihen nga Ivaja afër Kaçanikut në jug dhe vazhdojnë gjerë në Vërbovc (Glllogovc) në veri, të cilat paraqiten në formë të thjerrëzave, shtresave dhe nënshtresave. Paraqitjet kryesore shtrihen në zonën Sedllar-Petrashiticë-Caralevë. Zona tjetër e ngjashme shtrihet në Caralevë – Dugë - Karaçicë. Paraqitjet më të vogla janë zbuluar edhe në afërsi të fshatit Çikatovë, Nishor, Breshance dhe Goriqë në Veriperëndim të Suharekës.

Regjioni i Qëndresës (Tërstenikut) është një ndër paraqitjet e hekur- nikelit që janë hulumtuar në mënyrë më të detajuar gjatë vitit 1952. Vendburimi i hekur-nikelit gjendet në afërsi të fshatit Tërstenik në largësi rreth 1.5 kilometra nga hekurudha që lidhë Pejën me Fushë Kosovën në veri të stacionit hekurudhor Bajicë. Vendburimi ka mbi 0.5 milion ton xehe me përmbajtje mesatare të Fe – 34.39% (max. 41.5%) të Ni - 0.98% (max.- 1.9%), Cr – 1.39% dhe Co – 0.1%.

#### Kromi (Cr)

Hulumtimet e kromit janë kryer në shumë lokalitete në Kosovë, kurse përqendrimi i hulumtimeve ishte në masivet ultrabazike të Gjakovës, Rahovecit, Lubotenit, Brezovicës, Goleshit, Dobroshevcit etj. Paraqitjet e kromit kryesisht janë të lidhura me dunitë. Kromi lajmërohet në formë thjerrëzash, pllakash, apo forma të çrregullta.

Kompleksi ofiolitik i Gjakovës shtrihet në sipërfaqe prej rreth 80 km<sup>2</sup>, dhe është pjesë e kompleksit ofiolitik të Mirditës(Shqipëri) i cili karakterizohet me shumë vendburime të kromit me rezerva shumë

<sup>18</sup> Boksitet e Kosovës - “Raporti i pyetësorit për miniera”, Klinë, Prill.2006.

më të mëdha. Vendburimi më i njohur i xeheve të kromit në Kosovë, ka qenë miniera e kromit Deva tani e shfrytëzuar e cila gjendet në afërsi të kufirit me Shqipërinë. Në këtë regjion kanë qenë të njohura edhe vendburimet: Babaj Bokës, Kralevica, Pllanik-Ponoshec, Popovc, Çafë Prush, etj.

Vendburimet minerale të kromit në regjionin e Brezovicës ndodhen në disa nivele të ultrabaziteve. Koncentrimi i kromit është i lidhur me dunite. Në regjionin e Brezovicës, ekzistojnë paraqitje dhe vendburime të pashfrytëzuara që gjenden në shkëmbinj ultrabazikë mes Ostrovicës e Jazhincës. Në masivin ultrabazik të Rahovecit janë zbuluar rreth 20 paraqitje. Paraqitjet dhe vendburimet mund të jenë ekonomike, sidomos në pjesën lindore të masivit. Me hulumtime të reja që janë realizuar gjatë viteve 2010-11 është zbuluar vendburimi i kromit në afërsi të fshatit Llapqevë. Hulumtimet e Kromit dhe zbulimet në Llapqevë janë realizuar nga kompania "Arsi sh.p.k.", që ka hulumtuar në bazë të licencës për hulumtim të lëshuar nga ana e KPMM.

Kromi është shfrytëzuar pothuajse në të gjitha regjionet e paraqitjes së tij. Në Kosovë deri më 1991 kur u bë ndërprerja e shfrytëzimit të tij, janë shfrytëzuar 1.02 Mt xehe kromi.

## Mangani (Mn)

Vendburimi më i rëndësishëm i Mn, sipas të dhënave të kompleksit Trepça gjendet në zonën e minierës ekzistuese të Artanës ku përmes tjetërsimit të Pb-Zn është formuar mineralizimi i Mn-Fe. Resurset e vlerësuara të manganit në këtë vendburim janë rreth 5 milionë ton xehe, me përmbajtje rreth 22 % Mn. Valorizimi i xehes së Mn nga ky lokacion, duhet të paraprihet me shqyrtimet teknike të gjendjes dhe mundësive të qasjes në minierën e mbyllur të Mn, si dhe kërkimet programore të mundësisë dhe efekteve të koncentrimit të Mn nga xehja në koncentrat, me metoda të flotacionit dhe me metoda të koncentrimit magnetik.

## Bakri (Cu)

Ekzistojnë disa paraqitje dhe mineralizime të bakrit. Hulumtimet themelore kanë përfshi terriore të shumta në Malet e Sharit afër Dragashit (OkraVno, Kukolan, Ovnishte), Bjeshkët e Nemuna, Pashtrik, Junik, Rexhancë në afërsi të Hanit të Elezit, Karadak (Pidiq, Binaq, Çelik), Guri Kuq (Petkoviq), Karavan Sali etj. Mineralizimet e bakrit janë të lidhura me epoka të ndryshme metalogjenike. Në pjesën perëndimore të Kosovës këto mineralizime janë të lidhura me vullkanizmin spilit-diabaz-keratofir.

Nuk ekzistojnë të dhëna mbi rezervat/resurset. Megjithatë, paraqitjet e shpeshta të bakrit tregojnë që ka potencial të lartë për zbulimin e vendburimeve të bakrit.

### 4.1.2.5 Metalet e rralla dhe Elementet e tokave të rralla

Në pjesët jugore të Kosovës janë zbuluar elemente të tokave të rralla, si dhe metale të rralla siç janë: arseni, molibdeni, kallaji, tungsteni dhe mercuri. Në pjesën lindore janë konstatuar paraqitjet e antimonit, kurse në veri, kemi paraqitje të merkurit, antimonit, arsenit etj. Nuk ka të dhëna më detaje për këto resurse pasi që mungojnë hulumtimet gjeologjike relevante.

Elementet e Tokave të Rralla (ETR) gjenden afër Nebregoshtit dhe Manastiricës. Analizat gjeokimike kanë dhënë një spektër prej rreth 20 elementesh (niob, lantan, cesium, skandium, zirkon, etj.). Njohuria mbi ETR-a është e pamjaftueshme për një vlerësim, për shkak të hulumtimeve të pakta.

#### 4.1.2.6 Metalet e grupit të arit dhe platinit

##### Ari (Au)

Në Republikën e Kosovës ari paraqitet në paragjenezë me xehe të bakrit, plumbit dhe zinkut si dhe i pastër (i vetëlindur) në depozitime aluviale të lumenjve. Gjerë tani ari dhe argjendi janë nxjerrë vetëm nga xehe e plumb-zinkut.

Hulumtime të pakta janë realizuar në territorin e gjerë të Artanës, Junikut, në lumin Tërnavë, Dragash, në afërsi të Prekovicit (Kriva Reka), Gllamë dhe në lindje të Koretishit.

Ari i cili është i lidhur me mineralizimet dhe vendburimet e plumb-zinkut, në nivelin e matshëm paraqitet në minierën e Artanës, ku përmbajtja e arit është më e madhe dhe kjo minierë njihet si vendburimi me përbërjen më të lartë të arit në Kosovë. Resurset e arit në minierën e Artanës vlerësohen të jenë 2,700 kg.

Sipas vendburimeve, vlerësohen këto përmbajtje të arit: Stantërg: 0.6 g/t, Bellobërdë: 0.7 g/t, Cërnac: 1.0 g/t, Hajvali: 0.5 g/t, Kizhnicë: 1.1 g/t, Badovc: 0.25 g/t, Artanë: 1.6 g/t, Crepulë: 0.13 g/t<sup>19</sup>.

##### Platina (Pt)

Nuk ka hulumtime mbi praninë e Metaleve të Grupit të Patinës (MGP) në Kosovë. Megjithatë, hulumtimet e kryera në zonën veriore të Republikës së Shqipërisë kanë dhënë indikacione që MGP-të mund të gjenden edhe në masivin ultrabazik të Gjakovës. Analizat e këtyre vendburimeve kanë treguar një korelacion pozitiv mes koncentrimin të platinës dhe kromit. Ka nevojë për hulumtime të hollësishme.

#### 4.1.3. Mineralet jo-metalore

##### 4.1.3.1 Mineralet industriale

Krahas mineraleve energjetike dhe metalore, për ekonominë e tregut janë të rëndësishme edhe shumë minerale jo-metalore.

##### Magneziti

Vendburimi më i njohur i magnezitit shtrihet në pjesën jugore të masivit ultrabazik të Goleshit dhe ndodhet në afërsi të fshatit Magurë. Vendburimi i magnezitit në Golesh i përket tipit hidrotermal dhe lokalizohet brenda serpentiniteve. Trupat xeherorë kanë formë thjerrëzore dhe damarore<sup>20</sup> me trashësi prej 1-6 m.

Vendburimi sedimentar i magnezitit në Strezovc gjendet në pjesën veriore të pellgut të Kamenicës dhe përbëhet nga tetë trupa të ndryshëm magneziti, me trashësi prej dhjetëra metrash.

Magneziti paraqitet edhe në masivin serpentinit të Dubofcit (Vushtrri), si damar hidrotermal me trashësi prej 7 deri në 25 m (pjesa më e madhe është shfrytëzuar).

Rezervat e magnezitit në minierën e Magurës janë rreth 2.4 Mt, në minierën e Strezovicit 1.7 Mt<sup>21</sup>

19 Miniera me flotacion, Trepça-Artana – Studimi i fizibilitetit”, Qershor 2006, dhe Miniera me Flotacion Kizhnicë dhe Artanë, “Raporti i pyetësorit për miniera”, Kizhnicë, Prill 2006.

20 XIM „Strezoci” dhe MIM „Goleshi” – “Raporti i pyetësorit për miniera”, Prishtinë, Prill 2006.

21 XIM „Strezoci” dhe MIM „Goleshi” – “Raporti i pyetësorit për miniera”, Prishtinë, Prill 2006.



*Prodhimi në të kaluarën.* Dy minierat kryesore të magnezitit: Goleshi dhe Strezoci, në fillim kanë funksionuar si miniera sipërfaqësore, kurse më vonë kanë aplikuar edhe metodën e shfrytëzimit nëntokësor.

Në periudhën kohore 1964–1999, nga miniera e magnezitit në Golesh janë shfrytëzuar rreth 4.6 Mt xehe, me përmbajtje prej 44.49% MgO, 0.2-5.0% SiO<sub>2</sub> dhe 0.2-1.5% CaO.

Miniera e Strezocit filloi shfrytëzimin sipërfaqësor në vitin 1962, duke vazhduar me aktivitetë nëntokësore në fillim të vitit 1986. Në Kamenicë, stabilimenti për sinterizim filloi punën më 1974. Kapaciteti vjetor nominal i këtij stabilimenti ishte rreth 20,000 t sinter magnezit. 4.1.3.2 Minerale teknike

## Kaolini

Vendburimi më i madh i kaolinës gjendet në juglindje të Karaçevës së Ulët, në lindje të Gjilanit. Miniera në Karaçevë të Ulët ka filluar të punojë që nga vitit 1965. Në përgjithësi, në Kosovë janë shfrytëzuar 372,000 t xehe mes viteve 1970 dhe 1981. Rezervat e vlerësuara të kaolinës në vendburimin në Karaçevë të Ulët janë rreth 3.2 Mt.

Republika e Kosovës disponon me katër fusha minerale me resurse totale të kaolinës prej rreth 14 Mm<sup>3</sup>.

Dy vendburime (Badovci dhe Karaçeva e Ulët) mund të radhiten më vlerë të lartë ekonomike.

Kaolini është hulumtuar mjaft në të kaluarën, por kufizimet ekonomike të këtyre resurseve kanë kushtëzuar edhe shfrytëzimin e kufizuar të tyre.

## Hallojziti

Hallojziti është një mineral argjilor i llojit alumosilikat, me formulë empirike Al<sub>2</sub>Si<sub>2</sub>O<sub>5</sub>(OH)<sub>4</sub>. Parqet një mineral me veti të mira mikrostrukurore dhe karakterizohet me pastërti të lartë që i mundëson përdorimin në farmaci dhe në industrinë kimike. Është zbuluar në zonën e minierës së plumb-zinkut të Artanës. Minerali argjilor i bardhë, apo kaltër-bardhë, është zbuluar gjatë shfrytëzimit të Pb-Zn në vendburimin Përroi i Ngjyrosur. Resurset e Hallojzitet brenda minierës së plumb-zinkut të Artanës supozohet të jenë rreth 2 Mt. Shfrytëzimi i Hallojzitet, nuk mund të shikohet ndaras nga prodhimi i xehes në minierën e Artanës, kështu që projekti i shfrytëzimit të këtij minerali, teknikisht dhe ekonomikisht do të jetë pjesë përbërëse e shfrytëzimit kompleks të xehes dhe mineraleve në minierën e Artanës.

Hallojziti në Kosovë është një nga pesë vendburimet që ka mundësi të shfrytëzohet, ndërsa katër të tjerat gjenden në Zelandë të Re, Turqi, Kinë dhe Juta/SHBA. Prodhimi aktual botëror vlerësohet të jetë rreth 150,000 t/v. Është me interes të madh vazhdimi i hulumtimit të këtij minerali<sup>22</sup>.

## Bentonitet dhe argjilat bentonite

Paraqitjet dhe vendburimet e bentoniteve kryesisht shtrihen në pjesën juglindore të Kosovës. Republika e Kosovës disponon me shtatë fusha minerale, me resurse totale prej rreth 25 Mm<sup>3</sup>. Megjithatë, rekomandohet hulumtimi i më tutjeshëm i bentoniteve<sup>23</sup>.

22 Miniera me Flotacion Kizhnicë dhe Artanë, "Raporti i pyetësorit për miniera", Kizhnicë, Prill 2006.

23 ICMM-"The compilation of Geo-Scientific Map of Kosovo", Prishtinë, June 2005, page 67



## Kuarci

Kuarci si mineral industrial i cilësisë dhe me pastërti të lartë gjendet në Kosovën lindore, qendrore dhe jugore. Paraqitjet dhe vendburimet më të njohura gjenden në: Strezoc, në jug të Binçës, në perëndim të Bukovikut dhe Debelldesë, etj. Rezervat e kuarcit në vendburimin e Strezocit janë llogaritur të jenë 2.53 Mt dhe në zonën e Binçës, 3.1 Mt, kurse vendburimi i Bukovikut (në juglindje të Kosovës) përmban rreth 19 Mm<sup>3</sup>.

Kosova disponon me 33 fusha minerale të kuarcit me resurse totale prej rreth 340 Mm<sup>3</sup>. Megjithatë, niveli i hulumtimit të paraqitjeve të kuarcit është i ulët dhe kërkon hulumtime shtesë.

Në Republikën e Kosovës janë zbuluar edhe shumë paraqitje dhe vendburime tjera të mineraleve industriale që kanë rëndësi ekonomike për shfrytëzim dhe përpunim, e ato janë: Azbesti, Diatomiti, Talku, Sepioliti, Leuciti, etj<sup>24</sup>.

## Argjila

Kosova disponon me resurse të mëdha të argjilës. Vendburimet më të njohura janë ai i Gjakovës (përbëhet nga argjila e përhirtë deri në të verdhë-hirtë, me trashësi deri në 8 metra), i Landovicës në veriperëndim të Prizrenit (karakterizohet me shtresimin e argjilave lymore dhe me rërë. Trashësia mesatare është rreth 17 m).

Në Skenderaj, argjilat lymore kanë trashësi deri 9 metra, ndërsa vendburimi tjetër i argjilës gjendet në Llapashticë të Epërme në perëndim të Podujevës. Seria e argjilave me ngjyra të ndryshme arrin trashësinë deri 10 m. Në juglindje të Ferizajt, argjilat me trashësi mesatare prej 8.5 m janë hulumtuar me shpime hulumtuese. Edhe në juglindje të Kamenicës, argjilat e Miocenit janë akumuluar në trashësi prej 5 deri në 30 m.

### 4.1.4 Materialet ndërtimore

#### Shkëmbinjte e fortë silikatë

Në Republikën e Kosovës ekziston një numër i madh i paraqitjeve dhe vendburimeve të shkëmbinjve të fortë silikatë, që kanë mundësi të përdoren në ndërtimtari. Llojet e shkëmbinjve më të rëndësishëm silikatë, të përshtatshëm për prodhimin e materialeve ndërtimore, janë andeziti, trahiti, latiti, shkëmbinjte piroklastitë, ranorët, gabrot, duniti, diabazi, bazaltet, granitet, granodioritet, gneisi, migmatiti dhe kuarci.

Deri më tani, shkëmbinjte e fortë silikatë janë hulumtuar dhe shfrytëzuar rrallë dhe për shkak të cilësisë së tyre të lartë ata mund të bëhen burim i rëndësishëm i mineraleve ndërtimore në të ardhmen. Shfrytëzimi kryesor i mundshëm i shkëmbinjve të fortë silikatë, si lëndë e parë ndërtimore, është prodhimi i agregatëve si dhe perspektiva e shfrytëzimit si gurë dekorativë dhe dimensionalë.

Vendburimet e shkëmbinjve të fortë silikatë me vlera të larta gjenden kryesisht në pjesët veriore, verilindore dhe lindore të Kosovës. Në bazë të rezultateve të Planit të Guroreve të Kosovës (PGK), rekomandohet intensifikimi i hulumtimeve gjeologjike.

#### Shkëmbinjte e fortë karbonatikë

Janë hulumtuar dhe verifikuar rezerva të konsiderueshme të gëlqerorëve, të cilët përdoren si materiale gjeologjike në ndërtimtari dhe industri.

24 ICMM-“The compilation of Geo-Scientific Map of Kosovo”, Prishtinë, June 2005, page 64

Mermeri dhe gëlqerorët e mermerizuar gjenden kryesisht në zonat perëndimore të vendit. Ato përdoren si gurë dekorativë. Në Kosovë paraqitet e mermerit janë të njohura në afërsi të Mitrovicës, Gjilanit, mermeri i kuq në Junik, mermerët brekçiozë të Deçanit, të cilët mund të përdoren si gurë dekorativë dhe dimensionalë.

Në Kosovë janë të zbuluara vetëm tri paraqitje të dolomitëve dhe analizat e pakta kanë dhënë vlera të MgO (Oksidi i Magnezit) deri në 16%. Kështu, ata janë të klasifikuar si gëlqerorë dolomitikë. Dolomitët si të tilla gjenden në Kosovën perëndimore, në perëndim të Pejës dhe jashtë zonës së veprimtarisë së PGK-së.

Vendburimet e travertinit janë të kufizuara në burimin e ujit mineral afër Banjës së Pejës. Mund të gjenden edhe vendburime të vogla të formacioneve në zonën e gëlqerorëve karstikë. Këto vendburime nuk kanë ndonjë rëndësi ekonomike.

Republika e Kosovës disponon me 276 fusha minerale të gëlqerorëve me 7,690 Mm<sup>3</sup> dhe 120 fusha minerale të mermerëve me resurse totale prej r 2,186 Mm<sup>3</sup>. Ekzistojnë vetëm dy fusha minerale të dolomitëve<sup>25</sup> me resurse totale prej rreth 1.4 Mm<sup>3</sup>.

## Rëra dhe zhavorri

Ekzistojnë rreth 110 paraqitje dhe vendburime të rërës dhe zhavorrit. Prej tyre, vetëm disa paraqitje dhe vendburime të mëdha kanë përbërje minerale dhe kokrrizore adekuate, gjë që janë të përshtatshëm si lëndë e parë për prodhimin e betonit. Rezervat e rërës dhe zhavorrit në Republikën e Kosovës janë të koncentruara në shtretërit e lumenjve kryesorë, dhe për shkak të aktiviteteve intensive të shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit, pjesë të peizazhit të këtyre lumenjve janë dëmtuar shumë.

Vlerësohet që resurse totale të rërës dhe zhavorrit janë rreth 331 Mm<sup>3</sup>.

Bazuar në faktin se ndikimet mjedisore gjatë procesit të shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit janë të dukshme dhe qasja e kufizuar për shkak të destinimeve të tjera të tokës ku shtrihen këto vendburime, kjo veprimtari rezulton të jetë e pa-perspektivë dhe duhet bërë zëvendësimi i operimeve të tilla në favor të shfrytëzimit të shkëmbinjve të fortë silikatë dhe karbonatikë.

Megjithatë, meqenëse shtresimet dhe depozitimet e rërës dhe zhavorreve në shtretërit e lumenjve janë të ripërtrishëm (prurjet vjetore të lumenjve), çështja e lejimit të shfrytëzimit të kufizuar duhet të shtrohet pas një elaborimi më të detajuar, profesional.

Me vendimin nr. 02/46 të datës 02.11.2011 të lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, është ndaluar shfrytëzimi i materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat për rreth lumenjve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Vendimi nënkupton ndalimin e përkohshëm, deri në 3 vjet, të të gjitha aktiviteteve shfrytëzuese në lumenj dhe përreth tyre. Ky vendim ka qenë i domosdoshëm për të ndaluar përfundimisht degradimin e mëtejshëm të lumenjve.

## Rëra kuarcore

Rërat kuarcore si minerale ndërtimore janë të pranishme në Republikën e Kosovës qendrore, juglindore dhe jugperëndimore. Vendburimet më të njohura janë Mirosale dhe Sllovi. Paraqitet tjera janë më pak të hulumtuara, në Pashtrik afër Mazrekajt, Kojushë, Milaj etj. Sipas PGK-së, Kosova ka katër fusha minerale me resurse totale prej rreth 12 Mm<sup>3</sup>.

25 BEAK Consultants – "Plani i Guroreve të Kosovës", Prishtinë, Mars 2006

---

## Mergelët për çimento

Mergelët për çimento janë zbuluar në pjesën veriperëndimore dhe juglindore të Kosovës, në sedimente Paleogjenike. Vendburimi më i rëndësishëm i mergelëve për çimento gjendet në Han të Elezit. Mergelët për çimento në këtë vendburim janë homogjene, me trashësi deri në 50 m dhe janë përbërësi kryesor për prodhimin e çimentos (SHARR-CEM-i) e cila këtu prodhohet që nga viti 1963.

Vetëm katër fusha minerale të mergelëve për çimento, janë vënë në listë në PGK, me resurse totale rreth 25 Mm<sup>3</sup>.

## Gurët dekorativë dhe dimensionalë

Kosova ka potencial të mirë për gurë dekorativë dhe dimensionalë. Hulumtimet e gjertanishme janë të pakta dhe kërkohen hulumtime e kërkime gjeologjike të tjera. Gjeo-databaza e Kosovës (GDK) përmban të dhëna për mbi 116 lokacione të gurëve dimensionalë dhe dekorativë. Aktualisht, vetëm një pjesë e vogël shfrytëzohet në gurore të vogla, nga kompanitë e Kosovës me pak punëtorë.

Përshtatshmëria për gurë dekorativë dhe dimensionalë ende nuk është hulumtuar. Nuk ekzistojnë të dhëna mbi blloqet e përshtatshme për shfrytëzim dhe për humbjet gjatë shfrytëzimit. Nevojiten hulumtime të hollësishme teknike dhe petrografike, si dhe zgjerimi i bazës së të dhënave mbi rezervat/resurset.

## 5. ANALIZA E AFTËSISË KONKURRUSE –SWOT

Analiza SWOT është një instrument i cili konsiderohet i dobishëm për identifikimin e faktorëve të brendshëm ndikues në sektorin minerar, siç janë përparësitë dhe dobësitë, si dhe faktorëve të jashtëm, siç janë mundësitë dhe rreziqet që kanë ndikim në zhvillimin e sektorit minerar.

Tabela e mëposhtme paraqet përparësitë, dobësitë, mundësitë si dhe rreziqet të cilat lidhen me gjendjen aktuale të sektorit minerar në Kosovë. Analiza SWOT është përgatitur pas një analize të materialeve, studimeve dhe shkëmbimit të ideve me ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve relevante lidhur me sektorin.

Përparësitë i referohen aftësive të cilat mundësojnë dhe lehtësojnë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar. Ato mund të përdoren për shfrytëzimin e të gjitha mundësive, për zbutjen dhe zvogëlimin e dobësive si dhe për reduktimin e Rreziqeve.

Dobësitë janë mungesa të cilat e pengojnë dhe e rendojnë zhvillimin e sektorit. Janë identifikuar një numër dobësish të ndryshme që kanë të bëjnë me mungesën e infrastrukturës ligjore, teknologjinë e vjetruar, mungesa e kapitalit për zhvillimin e kapaciteteve prodhuese, moshën e vjetër e stafit të kualifikuar në kompanitë minerare. Këto dobësi do të adresohen në objektivat, I.1, I.2, II.2, dhe III.1.

Mundësitë janë raste të mira për zhvillimin e mëtejshëm. Këto mundësi kryesisht lidhen me reformat të cilat do të krijojnë mundësi të investimeve, rritjes së kërkesës për produktet minerale dhe shtimit të vlerës së këtyre resurseve.

Rreziqet paraqesin sfida të jashtëzakonshme, të cilat mund të pengojnë dhe ngadalësojnë përparësitë e identifikuar apo mund të përshpejtojnë dobësi të caktuara duke penguar në këtë mënyrë shfrytëzimin e mundësive. Kriza globale financiare, kapaciteti i ulët financiar, ndërtimet e pakontrolluara që zënë sipërfaqet me minerale, dëmet e mëdha të shkaktuara mjedisore që kanë kosto tepër të madhe për zgjidhjen e tyre, si dhe pakënaqësitë eventuale me rastin e reformave në sektor janë rreziqe të identifikuar. Këto rreziqe janë adresuar në objektivat, I.2, III.1 dhe IV.1.

### **Përparësitë**

- Zhvillimi i industrisë minerare është prioritet i Qeverisë
- Rezervat e konsiderueshme minerale
- Disa nga minierat ekzistuese janë të gatshëm të kalojnë nga faza e mirëmbajtjes në prodhim
- Ekzistenca e resurseve minerare të gatshme për hulumtime të detajuara
- Kuadro të reja që lehtë mund të trajnohen konform teknologjive të reja
- Kostoja e fuqisë punëtore relativisht e ulët
- Pozita e përshtatshme gjeografike e Kosovës në rajon
- Tradita e gjatë në sektorin minerar si dhe pranueshmëria e lartë publike për industrinë minerare

### **Dobësitë**

- Infrastrukturë jo e mjaftueshme ligjore dhe rregullatore
- Teknologjia kryesisht e vjetruar
- Mungesa e kapitalit vetanak të minierave për të investuar në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese
- Potenciali i ulët i kapitalit vendor privat për investime në miniera
- Mungesa e kuadrit të specializuar në aspektin ligjor dhe rregullator
- Struktura e pafavorshme e moshës së kuadrit të kualifikuar në kompanitë minerare
- Efektet negative mjedisore të shkaktuara nga aktivitetet minerare
- Mungesa e një sistemi të përhershëm monitorues të ndotjeve

### **Mundësitë**

- Reformat qeveritare për tërheqjen e investimeve
- Rritja e kërkesës për energji
- Rritja e kërkesës për produkte minerale
- Mundësia e gjenerimit të vlerës së shtuar duke integruar të gjitha fazat, përfshirë edhe finalizimin e produkteve minerale
- Zbulimi i resurseve të reja minerale

### **Rreziqet**

- Kriza financiare globale,
- Ndryshimet globale në tregun e mineraleve
- Jo stabiliteti i mundshëm rajonal
- Niveli i ulët i kapaciteteve financiare publike për investime në infrastrukturë
- Ndërtimit i pakontrolluar në zonat me interes të veçantë
- Dëmet mjedisore të bëra në të kaluarën të pazgjdhura
- Pakënaqësitë sociale gjatë reformimit të sektorit minerar

---

## 6. SFIDAT PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT MINERAR

Zhvillimi i shpejtë dhe i qëndrueshëm ekonomik dhe social i Kosovës do të varet ndjeshëm nga zbatimi i politikave dhe reformave të përshtatshme ekonomike dhe strukturore që mundësojnë shfrytëzimin sa më racional të resurseve natyrore dhe njerëzore të saj.

Gjendja aktuale e sektorit minerar nuk mundëson arritjen e qëllimit, prandaj kërkohet reformim dhe ristrukturim i sektorit minerar bazuar në principet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfitimit maksimal të shoqërisë dhe shtetit nga shfrytëzimi i resurseve minerare.

Sfidat kryesore ekonomike në sektorin minerar janë:

1. Financimi, rehabilitimi i minierave ekzistuese dhe funksionalizimi i tyre sa ma i shpejtë dhe me kosto sa ma të vogël (ulët);
2. Procesi i riorganizimit të NSH të sektorit minerar;
3. Tërheqja e investimeve vendore dhe të huaja në sektorin minerar, valorizimi dhe rritja e shkallës përpunuese për minerale të caktuara deri në produkte ose gjysmë produkte,
4. Harmonizimi i programeve universitare me nevojat e sektorit minerar dhe stimulimi i gjeneratave të reja në zhvillimin e këtij sektori;
5. Hulumtimi i mëtutjeshëm për identifikimin e resurseve të reja minerale në Kosovë;
6. Zhvillimi i industrisë përpunuese në sektorin minerar dhe gjetja e tregjeve të reja në tregun botëror.
7. Zhvillimi i minierave për prodhimin e linjtit.

## 7. OBJEKTIVAT, POLITIKAT DHE MASAT PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT MINERAR

Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar të sigurojë që resurset minerale të jepen në shfrytëzim duke maksimizuar përfitimet për Kosovën në kushtet e një tregu të lirë, të hapur dhe transparent.

Për këtë qëllim, synohet të krijohet një ambient ligjor, rregullator dhe fiskal tërheqës për investitorët, që i siguron Kosovës të ardhura të të njëjtit nivel proporcional me vendet me eksperiencën më pozitive në optimizimin e shfrytëzimit të resurseve minerare.

Objektivat strategjike të paraqitura në këtë strategji minerare janë bazuar në analizën gjithëpërfshirëse të:

- Gjendjes aktuale të sektorit minerar;
- Analizës SWOT;
- Programit të Qeverisë të Republikës së Kosovës; si dhe
- Përkushtimin e Kosovës për zhvillimin e sektorit minerar në përputhje me standardet dhe rregullat ndërkombëtare për mjedisin.

Objektivat strategjike janë të paraqitura për secilën shtyllë dhe në vete përmbajnë politikat dhe masat të cilat do të krijojnë kornizë të qartë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe trajtim miqësor për mjedisin.

**Shtylla I. Krijimi i kushteve të favorshme për shfrytëzim dhe valorizim ekonomik të resurseve minerare dhe tërheqje të investimeve.**

### Objektivi I.1. Plotësimi i Infrastrukturës ligjore dhe rregullatore

Qeveria e Republikës së Kosovës është duke punuar në plotësimin e infrastrukturës ligjore e cila do të mundësojë që sektori minerar të zhvillohet dhe të shfrytëzohet në dobi të zhvillimit ekonomik dhe social të Republikës së Kosovës. Për të realizuar këtë qëllim, Qeveria do të jetë palë kryesore në të gjitha proceset vendimmarrëse që kanë të bëjnë me sektorin minerar të Republikës së Kosovës.

Infrastruktura e përshtatshme ligjore dhe rregullative do të mundësojë ristrukturimin e plotë të sektorit minerar dhe ndërmarrjeve, më qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e aseteve ekzistuese për tërheqjen e investimeve dhe mundësimin e krijimit dhe zhvillimit të bizneseve për të siguruar shtimin e prodhimit, përpunimit të resurseve minerale në vend dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Rregullimi dhe sanksionimi i trajtimit të çështjes mjedisore e sociale, shpronësimi i drejtë, përcaktimi i metodologjive të mbylljes së aktivitetit minerar, licencimi i kompanive për hulumtim, projektim dhe operim në sektorin minerar, përcaktimi i të ardhurave të shtetit nga ky sektor dhe përfitimet që do të këtë komuniteti lokal, janë disa nga fushat të cilat do të rregullohen me ligje dhe akte nënligjore. Kjo infrastrukturë ligjore do të mundësojë krijimin e ambientit tërheqës për investime dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me qëllim krijimin e sa më shumë vendeve të reja të punës.

**Masat për realizimin e këtij objekti:**

- I.1.1 Plotësimi i bazës ligjore që mundëson reformimin dhe ristrukturimin e sektorit minerar në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare;



- I.1.2 Plotësimi i legjislacionit për shpronësim të drejtë në zonat e destinuar për aktivitete minerare;
- I.1.3 Hartimi i ligjit për mbetjet nga veprimtaria minerare, ligj ky i bazuar në Direktivën e Bashkimit Evropian 2006/12/ EC;
- I.1.4 Krijimi i bazës ligjore për trajtimin dhe rehabilitimin e zonave të kontaminuara;
- I.1.5 Zbatimi i ligjit, akteve nënligjore dhe rregulloreve teknike të mbrojtjes në punë;
- I.1.6 Përcaktimi i metodologjive të mbylljes së aktivitetit minerar dhe monitorimit post minerar;
- I.1.7 Përcaktimi i formave të privatizimit të ndërmarrjeve të sektorit minerar si dhe mënyrën e vlerësimit të pasurisë;
- I.1.8 Përcaktimi i marrëdhënieve midis pronarëve të tokës dhe zotëruesve të lejeve minerare;
- I.1.9 Hartimin dhe zbatimin e procedurës së qartë të alokimit për resurse të pazhvilluara minerale;
- I.1.10 Hartimi i rregulloreve për licencimin e kompanive projektuese dhe reviduese.

## Objektivi I.2. Hartimi i politikave zhvillimore për sektorin minerar

Qeveria do të ketë rol vendimtar në proceset e ristrukturimit dhe organizimit të ndërmarrjeve minerare në vend me qëllim rivitalizimin e tyre, në mënyrë sa më transparente, ekonomikisht efikase, duke rritur interesimin e investitorëve potencial.

Kështu, politikat zhvillimore do të orientohen në drejtim të krijimit të legjislacionit për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit sipas standardeve ndërkombëtare, tërheqjes së investimeve private, reformimit të plotë të sektorit, mbrojtjes së mjedisit dhe trajtimit të çështjeve sociale të ndikuara nga aktiviteti minerar, si dhe krijimit të kapaciteteve të mjaftueshme institucionale dhe profesionale, për t'ju përgjigjur sfidave në dobi të zhvillimit të sektorit në rrethana të një tregu të lirë dhe konkurrues. Valorizimi i resurseve/rezervave minerale do të bëhet duke i vendosur ato në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit, posaçërisht resurset minerare të linjtit dhe të xeheve Pb-Zn.

Resurset e linjtit klasifikohen në grupe sipas destinimit të tyre si në vijim:

- Resurset për prodhimin e energjisë elektrike nga linjiti, që nënkupton realizimin në tërësi të Strategjisë së Energjisë, duke e destinuar Fushën e Linjtit të Sibovcit (Mihja e re) me kapacitet prodhues të mjaftueshëm për furnizim të termocentraleve ekzistuese dhe atyre të reja që do të ndërtohen;
- Pjesët veriore, në vazhdim të fushës linjit mbajtëse të Sibovcit, do të parcializohet nga Instituti gjeologjik i Kosovës (IGJK) me mundësinë e privatizimit dhe zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM). Fushat Linjit mbajtëse të Drenicës (Drenas dhe Skenderaj) do të destinohen për shfrytëzim komercial nga investitorët privat;
- Në pellgun qymyr mbajtës të Dukagjinit, Fusha e Tuçepit do të destinohet për kimizimin e linjtit me metoda dhe teknologji bashkëkohore përmes investimeve private;
- Fushat tjera të specifikuar në Pellgun qymyrmbytës të Dukagjinit (A, B, C dhe Fusha Kline-Kusar), duhet të hulumtohen me punime kërkimore shtesë me qëllim të definimit të plotë të potencialit, në harmoni me rregulloret për klasifikim.

## Masat për realizimin e këtij objekti:

- I.2.1 Promovimi dhe zhvillimi i parimeve për zhvillim të qëndrueshëm (zhvillimi që plotëson nevojat aktuale, pa dëmtuar interesat e brezave që vijnë).
- I.2.2 Tërheqja e investimeve private në sektorin minerar nëpërmjet krijimit të kushteve të përshtatshme për investime;
- I.2.3 Ristrukturimi i sektorit minerar me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e aseteve ekzistuese për të siguruar shtimin e prodhimit dhe përpunimit të resurseve minerare në vend. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet riorganizimit të Trepçës, në harmoni me interesat e qytetarëve dhe shtetit të Kosovës;
- I.2.4 Valorizimi i produkteve minerale, duke krijuar kushte për finalizimin e produkteve minerale. Inkurajimi i sektorit privat për zhvillimin e përpunimit të produkteve minerale;
- II.2.1 Sigurimi i transparencës në të gjitha fazat e aktiviteteve minerare (licencim, hulumtim, shfrytëzim, përpunim dhe mbyllje të minierave). Nisja e procedurave për antarsim në EITI (Extractive Industries Transparency Initiative) me qëllim të rritjes së transparencës në shfrytëzimin e resurseve minerare.
- I.2.5 Promovimi i resurseve minerare përmes publikimit të informacioneve dhe dokumentacioneve relevante të nevojshme për nxitjen e investimeve, bashkëpunimi ndër-institucional me synim arritjen e një procedure 'one-stop-shop' për investitorët potencialë, organizimi i konferencave për tërheqjen e investimeve dhe angazhimi i përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës në vendet e tjera për promovimin e investimeve në sektorin minerar;
- I.2.6 Promovimi i vendburimeve të boksive, manganit dhe mineraleve të tjera, për të cilët paraprakisht ka një informacion gjeologjik dhe plasimi i tyre në tregun minerar në fazat e hulumtimit ose shfrytëzimit;
- I.2.7 Krijimi i kushteve për pjesëmarrjen e komunitetit në të gjitha fazat e projektit dhe sigurimi që komuniteti do të përfitojë nga sektori minerar;
- I.2.8 Trajtimi i çështjeve mjedisore historike dhe zbatimi i rreptë i ligjeve dhe rregullave tjera që kanë të bëjnë me mjedisin gjatë aktivitetit minerar. Shfrytëzimi në mënyre racionale të vendburimeve duke mbrojtur maksimalisht mjedisin. Për këtë kërkohet respektimi i Standardeve Evropiane për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet përdorimit të teknologjive të avancuara dhe komercialisht të vërtetuara, dhe rikultivimi i mjedisit pas shfrytëzimit të vendburimit mineral.
- I.2.9 Kujdesi lidhur me të punësuarit në sektorin minerar aktual të cilët do të ndikohen nga reformat në sektor.

## Objektivi I.3. Zhvillimi i politikave fiskale

Për të stimuluar rritjen ekonomike të vendit, Qeveria do të hartojë politika të drejta dhe të pranueshme në grumbullimin dhe në shfrytëzimin e rentave minerale, duke i orientuar ato në investime të reja në infrastrukturë, në industri, si dhe në aktivitete të tjera të cilat do të ndikojnë në rritjen e punësimit, në ngritjen e eksportit, në uljen e importit dhe në ngritjen e përgjithshme të standardit jetësor të komuniteteve.

Përfitimet nga zhvillimi i resurseve minerare ndër të tjera do të realizohen përmes: rentave minerare,

tatimit në fitim të korporatave, tarifave të shfrytëzimit dhe licencave, si dhe të gjitha tatimeve tjera të përcaktuara me ligj.

Procesi i përcaktimit të strukturës dhe natyrës së taksave të aplikuara në sektorin minerar, është një çështje e politikave publike:

**Politikat e taksave minerare optimale** - Taksat e larta qeveritare ndaj sektorit minerar, ndikojnë pozitivisht në buxhetin e shtetit, por shpesh i detyron kompanitë minerare që të reduktojnë investimet. Kështu, përcaktimi i nivelit optimal të taksave minerare, është tregues i mirë i aftësisë për menaxhim të mirë të politikave publike në vend.

**Përzgjedhja optimale e taksave** - Në sektorin e minierave mund të aplikohen lloje të ndryshme të taksave, duke përfshirë këtu edhe llojet e ndryshme të royalty taksave. Përcaktimi për llojin dhe nivelin e taksave bëhet duke kërkuar një efikasitet më të lartë ekonomik, për të bërë një ndarje të baraspeshuar të riskut ndërmjet partnerëve (shtetit dhe kompanive minerare), si dhe që aplikimi dhe llogaritja e tyre të jetë e lehtë për tu administruar.

Sipas praktikave të mira në botë, sot preferohet që royalty taksat të përcaktohen duke u mbështetur në njërin nga këto tri parime:

1. Taksa Royalty 1 (R1), e cila llogaritet në bazë të njësisë fizike të prodhimit minerar;
2. Taksa Royalty 2 (R2), e cila llogaritet në bazë të vlerës së shitur të produkteve minerare, qoftë për njësi apo në baza vjetore; dhe
3. Taksa Royalty 3 (R3), e cila llogaritet në bazë të profitit që realizon kompania xehëtare në fund të vitit financiar;

**Taksat e llojit R1**, të cilat përllogariten për ton apo m<sup>3</sup> të materialit të nxjerrë nga vendburimi, janë të përshtatshme për resurset të cilat vlerësohen në tregun vendor dhe të cilat nuk vlerësohen sipas përmbajtjes së ndonjë minerali (grade control). Në këtë mënyrë mund të përcaktohet taksa royalty për gurëthyesit e të gjitha materialeve ndërtimore dhe agregateve, nxjerrja dhe prodhimi i zhavorëve, e shisteve bitumenoze dhe e materialeve të tjera të ngjashme. Niveli i ngarkimit me këtë lloj takse konsiderohet optimal nëse do të merrte vlerën nga 0.5 deri në 1.8 €/m<sup>3</sup> të materialit të nxjerrur nga vendburimi.

Taksa R1 është e aplikueshme edhe në rastin e shfrytëzimit të linjiteve. Meqenëse shfrytëzimi i linjtit parashihet të bëhet në shkallë të ndryshme të kapaciteteve prej Ndërmarrjeve të Vogla dhe të mesme (NVM) e deri tek prodhimi në shkallë të gjerë të energjisë elektrike dhe kimizimi i tij, institucionet përkatëse, bazuar në Ligjin për Minierat dhe Minerale, do të përcaktojnë taksën në përputhje me zhvillimet e tregut.

**Taksat e llojit R2**, kanë si bazë llogaritëse të hyrat e korporatës të realizuara nga shitja e produkteve xehëtare (koncentrate, aliazhe metalurgjike e të ngjashme). Kjo mënyrë e përcaktimit të royalty, është e përshtatshme për minierat e plumbit dhe të zinkut. Norma e pranueshme e taksave të llojit R2 mund të jetë 4% - 6% nga vlera totale e faturuar ndaj blerësit të koncentrateve e që njëherit paraqet vlerën neto të kthyer nga metalurgjia – NSR (**N**et **S**melter **R**eturn). Taksa e llojit R2 gjithashtu, do të ishte adekuate edhe për shfrytëzimin e xeheve të ferronikelit, ashtu që norma prej 4% - 6% në vlerën e përgjithshme të të hyrave nga shitja e produktit në treg, të konsiderohej si një ngarkesë e baraspeshuar ndërmjet kërkesave të qeverisë dhe mbrojtjes së interesave afariste të kompanisë.

Kjo mënyrë e përcaktimit të taksës Royalty, vlerësohet se do të ketë efektet më të pranueshme, se sa po të aplikoheshin taksat e larta por që nuk janë të bazuara në profitabilitetin e kompanisë.

**Taksat e llojit R3**, të cilat si bazë llogaritëse kanë profitin e kompanisë xehëtare, përcaktohen duke

baraspeshuar riskun e afarizmit ndërmjet shtetit dhe kompanive minerare, posaçërisht kur luhatjet e çmimeve në treg janë të shpeshta dhe të mëdha. Ky sistem gjithashtu është i përshtatshëm për t'u aplikuar te kompanitë xehtare, të cilat me produktet e tyre i referohen ekskluzivisht kuotacioneve në bursat ndërkombëtare, siç është rasti i metaleve me ngjyrë, ferronikelit, hallojzitet, boksiteve, magnezitet, metaleve fisnike, elementeve të tokave të rralla, e të ngjashme. Norma e pranueshme e llojit R3 të taksës do të ishte 10% - 14% nga vlera e raportuar dhe e publikuar e profitit të kompanisë.

#### **Masat për realizimin e këtij objekti:**

- I.3.1 Adoptimi i një kornize fiskale më atraktive për aktivitete minerare, duke krijuar lehtësira për tërheqjen e investimeve dhe krijimin e bizneseve të reja;
- I.3.2 Rishikimi i rentave minerare me qëllim të arritjes së çmimit të rentës minerare sipas standardeve në industri dhe zhvillim të industrisë përpunuese e cila do të krijojë vlerë të shtuar ekonomike për zhvillim ekonomik dhe krijim të vendeve të reja të punës;

### **Objektivi I.4. Realizimi i rivlerësimit ekonomik të potencialit mineral**

Ndikimi makroekonomik dhe social i aktiviteteve aktuale dhe aktiviteteve të ardhshme minerare në Republikën e Kosovës, mund të përlogaritet përmes vlerësimit ekonomik. Vlerësimi ekonomik duhet të behet me qëllim të krijimit të pasqyrës së qartë lidhur me përfitimet që do të mund të krijohen nga industria minerare për shtetin dhe për komunitetet.

Deri me tani janë zhvilluar disa vlerësime lidhur me potencialin ekonomik mineral, por të gjitha vlerësimet kane sjellë paqartësi dhe dyshime për sa i përket rezultatit, për arsye se kane publikuar të dhëna të ndryshme lidhur me rezervat/resurset minerare.

Si rrjedhojë, nevojitet që në të ardhmen, të bëhen studime të hollësishme teknike dhe ekonomike për secilin vendburim mineral apo minierë.

#### **Masat për realizimin e këtij objekti:**

- I.4.1 Vlerësimi i potencialit ekonomik për sektorin mineral;
- I.4.2 Plotësimi i të dhënave për resurset minerare, pasi shënimet janë jo të plota;
- I.4.3 Realizimi i studimeve për vendburimet e mineraleve energjike dhe polimetalore duke analizuar edhe skenarë të ndryshëm të vlerësimit ekonomik për këto vendburime;

## **Shtylla II. Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe Institucionale në fushën e sektorit mineral**

### **Objektivi II.1. Zhvillimi institucional dhe i kapaciteteve njerëzore**

Mjaft i rëndësishëm vlerësohet, zhvillimi i më tejshëm i kapaciteteve institucionale politikëbërëse dhe rregullatore, si dhe zhvillimi dhe funksionalizimi i institucioneve të domosdoshme, siç është Instituti Gjeologjik i Kosovës dhe Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve, në përputhje me Ligjin për Minierat dhe Minerale.

Zhvillimi i kapaciteteve hulumtuese dhe atyre për aplikimin e teknologjive të reja është një tjetër fushë

---

ku kërkohet vëmendje dhe mbështetje e mëtejshme. Në këtë drejtim do të mbështeten institucionet kërkimore shkencore dhe universitetet.

Gjithashtu, kërkohet shkollimi inxhinierik adekuat për të prodhuar kuadro të gatshme që të përballojnë sfidat dhe kërkesat e institucioneve.

#### **Masat për realizimin e këtij objekti:**

- II.2.2 Forcimi dhe zhvillimi i institucioneve ekzistuese;
- II.2.3 Zhvillimi i Institutit Gjeologjik të Kosovës;
- II.2.4 Ngritja dhe zhvillimi i sistemit informativ për përcjelljen e zhvillimeve globale në sektorin minerar, përfshirë politikat zhvillimore dhe trendet ekonomike;
- II.2.5 Ngritja e kapaciteteve edukative-arsimore koherente me standardet e BE-së për rritjen e cilësisë së edukimit arsimor në përgatitjen e specialistëve të gjeologjisë, minierave, ekonomisë, mjedisit etj. Në këtë drejtim do të kërkohet nga Universiteti Publik që të zhvillohen programe të arsimit në nivel të inxhinierëve të diplomuar nga fusha e minierave me qëllim të harmonizimit me kërkesat Evropiane dhe ligjet vendore;
- II.2.6 Aftësimi për zbatimin e teknologjive bashkëkohore të komunikimit dhe informacionit;
- II.2.7 Krijimi i kushteve të duhura për ripërtëritjen e fuqisë punëtore në minierat aktive si dhe aftësimi intensiv i punëtorëve dhe stafit teknik mbikëqyrës, sipas kriterëve më bashkëkohore;

## **Objekti II.2. Hulumtimi i resurseve minerare dhe raportimi i tyre**

Në Kosovë, në të kaluarën janë kryer shume hulumtime gjeologjike me shpime të thella dhe metoda tjera si për qymyre ashtu edhe për metalet baze (Plumbi, Zinku, Argjendi). Megjithatë, shtrohet nevoja urgjente e krijimit të hartave gjeologjike me përpjesë 1: 50 000 deri në 1: 25 000.

Më formimin e IGJK krijohet para-kushtet për realizimin e hartave të tilla duke angazhuar fondet dhe kuadrot vendore të nevojshme për këtë punë voluminoze.

Resurset e pa zhvilluara minerale kërkojnë hulumtime dhe studime të mirëfillta për përcaktimin e potencialeve ekonomike të shfrytëzimit. Kërkohen shumë hulumtime gjeologjike të detajuara për të përcaktuar arsyeshmërinë e tyre ekonomike dhe gjithashtu, vendosja e standarteve të raportimit sipas klasifikimit ndërkombëtar.

#### **Masat për realizimin e këtij objekti:**

- II.1.1. Realizimi i programeve hulumtuese gjeologjike dhe minerare;
- II.1.2. Konsolidimi dhe zgjerimi i të dhënave gjeoshkencore;
- II.1.3. Para-vlerësimi ekonomik i vendburimeve minerale sipas standardeve moderne ndërkombëtare;
- II.1.4. Hartimi i studimit të fizibilitetit të rezervave të linjtit për Basenin e Kosovës, Dukagjinit dhe Drenicës, për të argumentuar fillimin e projekteve të reja në këto zona;
- II.1.5. Zhvillimi i zonave me interes të veçantë (përgatitja e informatave të plota për zonat me interes të veçantë për resurset minerare të shpallura nga Qeveria e Republikës së Kosovës);

- II.1.6. Përgatitja e Planit për Menaxhimin e Resurseve minerare;
- II.1.7. Vendosja e bashkëpunimit midis aktorëve vendore, përfshirë industrinë, institucionet shkencore, qeverisjen lokale dhe OJQ-të;
- II.1.8. Rivlerësimi i resurseve/rezervave minerale sipas klasifikimit të pranuar ndërkombëtar UNFC. Me aplikimin e këtij sistemi do të krijohet baza minerale e njëlojshme me atë ndërkombëtare, e ndërtuar mbi bazën e kriterëve të ekonomisë së tregut;
- II.1.9. Vendosja e standarteve të raportimit për resurse minerale sipas praktikave ndërkombëtare;

### **Shtylla III. Çështjet sociale dhe përfitimet e komunitetit**

#### **Objektiva III.1. Trajtimi i çështjeve sociale dhe siguria në punë**

Qeveria do të trajtojë me kujdes të veçantë çështjet sociale të trashëguara në sektorin minerar. Qeveria, edhe për një periudhë, do të vazhdojë të mbështesë me subvencione të kufizuara Trepçën. Këtë do ta bëjë brenda mundësive të saj dhe në përputhje me qasjen më të përshtatshme. Qeveria do të vazhdojë të konsultohet me organizatat përfaqësuese të punonjësve të sektorit minerar.

Siguria, mirëqenia dhe shëndeti i njerëzve të punësuar në sektorin minerar është një detyrim i rëndësishëm. Kështu, parandalimi i aksidenteve në punë në sektorin minerar do të jetë një nga çështjet që do të ketë kujdes të veçantë nga menaxhimi, udhëheqësit e minierave si dhe inspektorati përkatës.

Kompanitë hulumtuese, të shfrytëzimit dhe ato të pasurimit duhet të aplikojnë vlerësimin paraprak të rrezikshmërisë, si dhe aplikimin e rregullave dhe rregulloreve të shëndetit dhe sigurisë në punë. Siguria dhe prodhimi nuk mund të jenë të pavarur nga njëri tjetri dhe as nuk do të konsiderohen si të veçantë.

Rregullat lidhur me sigurinë në punë për sektorin minerar janë të rregulluara me legjislacion sekondar të nxjerrë nga MZHE në rregulloren nr. 06/2011 për sigurinë minerare.

#### **Masat për realizimin e këtij objekti:**

- III.1.1 Vazhdimi i mbështetjes me subvencione të kufizuara për Trepçën;
- III.1.2 Hartimi dhe zbatimi i programeve për ri-kualifikimin e punonjësve për të cilët punësimi në profesionin e mëparshëm është i pamundur;
- III.1.3 Forcimi i kontrollit në procesin e implementimit të sigurisë në vendin e punës;
- III.1.4 Ngritja e kualitetit të vlerësimit paraprak të rrezikshmërisë;
- III.1.5 Zbatimi i ligjit, akteve nënligjore dhe rregulloreve teknike të mbrojtjes në punë;
- III.1.6 Përmirësimi i kushteve të punës;
- III.1.7 Zbatimi i obligimeve ligjore në mënyrë që, para marrjes së licencës, kompania të përgatisë sigurimin për “të gjitha rreziqet” ndaj palëve të treta, që vlen përgjatë gjithë afatit të Licencës ose Lejes, në shumën minimale të caktuar nga KPMM-ja në bazë të nenit 6. pika 1.4. të Ligjit nr. 03/L-163.



## Objektivi III.2. Pjesëmarrja dhe përfitimi i komunitetit

Konsultimi me komunitetin është esencial, për t'u realizuar përfitimet e plota nga veprimtaria minerare, por në të kaluarën nuk është zhvilluar në masën e duhur. Për operacionet minerare, ai ka qenë i kufizuar në çështjet e shpronësimit dhe ri-strehimit. Rrjedhimisht, konsultimi dhe përfitimi i komunitetit është i rregulluar me legjislacion sekondar të hartuar nga MZHE (Rregullorja nr. 04/2011 për trajtimin e komunitetit në sektorin minerar).

### Masat për realizimin e këtij objekti:

- III.2.1 Mbështetja e institucioneve për zbatimin e rregullores (Rregullorja nr. 04/2011 për trajtimin e komunitetit në sektorin minerar);
- III.2.2 Përkrahja e forumit për zhvillim të komunitetit i cili ka për qëllim të përfaqësojë interesat dhe përfitimet e komunitetit;

## Shtylla IV. Përkujdesja për mjedisin

### Objektivi IV.1. Zgjidhja e problemeve mjedisore historike

Procesi i menaxhimit mjedisor duhet të dallojë detyrimet mjedisore historike dhe ndikimet aktuale mjedisore që gjenerohen nga aktivitetet minerare tani dhe në të ardhmen. E para paraqet zakonisht një ngarkesë për shoqërinë, pasi pronari i saj nuk mund të identifikohet.

Detyrimet mjedisore historike në Republikën e Kosovës janë të mëdha dhe janë identifikuar zonat problematike, që janë rezultat i punës së shfrytëzimit të linjtit dhe gjenerimit të energjisë elektrike, si dhe rezultat i punës shumëvjeçare të minierave dhe metalurgjikëve të Trepçës.

Trepça ka pasur një histori të gjatë të problemeve mjedisore, përfshirë derdhjet toksike/acidike, plehrat, emetimet e pluhurit, hedhurinat e pakontrolluara dhe deponit jo-stabile.

Këto detyrime historike, do të menaxhohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila së bashku me donatorët ka iniciuar dhe do të iniciojë veprime për eliminimin e plotë të zonave problematike apo minimizimin e ndotjeve tjera historike.

### Masat për realizimin e këtij objekti:

- IV.1.1. Realizimi i studimeve të cilat do të identifikojnë mbetjet nga veprimtaria minerare dhe të përcaktojnë formën për trajtimin e tyre;
- IV.1.2. Bashkëpunimi me institucione të specializuara vendore dhe ndërkombëtare për trajtimin e mbetjeve nga veprimtaria minerare;
- IV.1.3. Bashkëpunimi/koordinimi i aktivitetit me organizatat donatore për zgjidhjen e problemeve të trashëguara mjedisore;
- IV.1.4. Rehabilitimi i zonave të kontaminuara nga veprimtaria minerare sipas praktikave më të mira ndërkombëtare;
- IV.1.5. Përgatitja e propozimi i projekteve për rehabilitimin e zonave të kontaminuara të cilat do të financohen nga donacionet.



---

## Objektivi IV.2. Mbrojtja e mjedisit nga aktiviteti minerar

Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit gjatë hulumtimit, shfrytëzimit dhe përpunimit të resurseve minerare do të jetë një nga qëllimet kryesore dhe do të garantohet me legjislacion, rregulla dhe kufizime të rrepta, sipas standardeve të BE-së.

Pasuritë minerale duhet të shfrytëzohen në dobi të komunitetit, por njëkohësisht në respekt të plotë të mirëqenies së individit, nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe rehabilitimit të tij.

Fenomenet negative si pasojë e shfrytëzimit minerar, shfaqen me hapjen dhe zhvillimin e minierës. Institucionet do të kërkojnë që subjekti i licencuar për shfrytëzim të trajtojë këto fenomene në vazhdimësi edhe pas mbylljes së minierës. Për këtë arsye, subjektit të licencuar do të kërkohet të bëjë projektin për efektet negative në mjedis, masat parandaluese gjatë aktivitetit minerar edhe pas mbylljes së minierës deri në dorëzimin e minierës.

Duhet të jetë obligim i bartësit të së drejtës minerare që të angazhohet në proceset e pajtueshmërisë me komunitetet dhe grupet e interesit, për të marrë pajtimin e tyre paraprak në bazë të interesave reciprokë, për shembull në rastin e zhvendosjes së komuniteteve nga zonat e ardhshme të shfrytëzimit dhe rikultivimit/rehabilitimit të minierave, si sipërfaqësore ashtu edhe ato nëntokësore. Kjo përfshin edhe obligimin e rikultivimit të lokacioneve ku është bërë përpunimi i xeheve në të kaluarën, me anë të procedurave standarde mjedisore dhe vlerësimit të kostos.

### Masat për realizimin e këtij objekti:

- IV.2.1 Forcimi i institucioneve mbikëqyrëse dhe inspektuese të aktivitetit minerar;
- IV.2.2 Përcaktimi i metodologjive të mbylljes së aktivitetit minerar dhe monitorimit post minerar;
- IV.2.3 Shqyrtimi i mundësisë për ndërtimin e një sistemi të garancive financiare për mbylljen e minierave;
- IV.2.4 Realizimi i studimit për prurjet vjetore të inerteve nga lumenjtë kryesorë dhe përpilimi i planit të përgjithshëm mbi mundësitë e shfrytëzimit të inerteve nga aspekti i ruajtjes së mjedisit;
- IV.2.5 Rishikimi dhe adoptimi i planit të guroveve të Kosovës dhe përpilimi i një plani të veprimit për vënien e rregullit dhe mbrojtjen e mjedisit nga degradimet aktuale;
- IV.2.6 Adoptimi i plotë i standardeve mjedisore Evropiane;
- IV.2.7 Promovimi i përfshirjes së publikut në procesin e vendimmarrjes;

---

## 8. PROCESI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË MINERARE 2012 - 2025

Procesi i Hartimit të Strategjisë Minerare perbehet nga dy faza. Faza e parë përfshin përgatitjen e Strategjisë Minerare dhe aprovimin nga ana e Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ndërsa faza e dytë parashikon përgatitjen e programit trevjeçar të zbatimit të strategjisë, e cila do të aprovohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës pas aprovimit të Strategjisë Minerare nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

### 8.1. Programi i zbatimit të strategjisë minerare

Strategjia Minerare përbën kornizën themelore, në bazë të së cilës përcaktohen objektivat dhe prioritetet zhvillimore të sektorit minerar. Strategjia Minerare përcakton politikat dhe masat për zhvillimin e sektorit minerar në dobi të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale.

Programi i Zbatimit të Strategjisë Minerare përbën mekanizmin e domosdoshëm që MZHE të jetë në gjendje të detajojë politikat, të alokojë detyrat, të ndër marrë aksionet specifike dhe të monitorojë progresin e realizimit të Strategjisë Minerare.

Në Programin e Zbatimit do të grupohen aktivitetet në kuadër të secilës shtyllë/objektiv, do të paraqitet afati kohor i realizimit, institucioni përgjegjës dhe mbështetës për zbatimin e aktivitetit, kostoja e realizimit të aktivitetit dhe kostoja e përgjithshme e planifikuar për periudhën kohore si dhe burimi i financimit.

Programi i Zbatimit do të shërbejë si dokument bazë për përgatitjen e propozim-projekteve të cilat do të realizohen në të ardhmen me financim nga institucionet publike apo donatorët.

### 8.2. Metodologjia për përgatitjen dhe monitorimi i programit

Përgatitja e Programit të Zbatimit do të jetë faza e dytë në kuadër të finalizimit të Strategjisë Minerare. Për përgatitjen e Programit të Zbatimit MZHE do të mbajë takime dhe do të konsultojë të gjitha institucionet relevante që kanë të bëjnë me sektorin minerar. Do të konsultojë programin e Qeverisë, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe programet e investimeve nga donatorët.

Monitorimi i realizimit të programit do të bëhet përmes përgatitjes së raportit të rregullt vjetor, i cili duhet të kryhet brenda muajit të dytë të vitit vijues.

